




ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT PËRFUNDIMTAR

MBI GJETJET DHE KONKLuzionET E
MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE
PARLAMENTARE
PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

**5 Bashki të vendit: Malësi e
Madhe, Dibër, Lezhë, Pogradec
dhe Berat**



bashkëpunimi
gjerman

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Drejt integritetit më të mirë të kandidatëve, për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme në 5 Bashki të vendit”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga Republika Federale Gjermane.

RAPORT PËRFUNDIMTAR

**MBI GJETJET DHE KONKLUZIONET E MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE
PARLAMENTARE PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

25 PRILL 2021

Tiranë, Qershor 2021



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Drejt integritetit më të mirë të kandidatëve, për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme në 5 Bashki të vendit”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga Republika Federale Gjermane.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



bashkëpunimi
gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Republikës Federale Gjermane.

Përgatiti:

1. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Koordinatore Projektesh, KShH
2. Znj. Servete Çeka, Juriste/Asistente Projektesh, KShH

Supervizuan dhe rishikuan raportin:

1. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor i KShH-së
2. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor:

©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Përmbajtja e Raportit:

Hyrje	5
1. Përmbledhje Ekzekutive	7
2. PROCESI PARAZGJEDHOR NË 5 BASHKI TË VENDIT.....	11
2.1. Publikimi i ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë dhe i listave përfundimtare të zgjedhësve	11
2.2. Respektimi i të drejtës së diasporës shqiptare për të votuar gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2021 .	12
2.2.1. Mohimi i të drejtës për të votuar i shtetasve të diagnostikuar dhe të karantinuar nga Covid-19.....	14
2.3. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve.....	15
2.4. Regjistrimi i Subjekteve Zgjedhore	15
1.....	16
2.5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	18
2.5.1. Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet.....	19
2.5.2. Komisioni Rregullator.....	20
2.5.3. Komisioni i Sanksioneve dhe Ankimimeve	20
2.6. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor.....	20
2.7. Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve	21
2.7.1. Mbledhjet dhe vendimmarrjet e KZAZ-ve.....	22
2.7.2. Anëtarët e KZAZ-ve që ushtrojnë funksione publike	23
2.8. Ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV)	24
2.8.1. Kualifikimi arsimor dhe trajnimi i anëtarëve të KQV-ve.....	24
2.9. Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) dhe trajnimi i tyre	25
2.10. Fushata Zgjedhore.....	25
2.10.1. Përdorimi i aseteve dhe administratës publike gjatë fushatës zgjedhore.....	25
2.11.1 Afishimi i materialeve propagandistike	27
2.11.2 Incidentet gjatë fushatës parazgjedhore, si indicie për shitblerje të votave.....	28
3 Procesi i votimit.....	29
3.1 Heshtja Zgjedhore	29
3.2 Shpërndarja e materialeve zgjedhore nga KZAZ drejt KQV	30
3.3 Monitorimi i procesit të Votimit.....	30
3.3.1 Sfidat e përdorimit të pajisjes elektronike PEI dhe parregullsitë e vërejtura si rrjedhojë e implementimit të teknologjisë	31
3.3.2 Aksesit i vëzhguesve të KShH-së gjatë votimit.....	32
3.3.3 Procedura e paraqitjes së zgjedhësit pranë dhomës së fshehtë	33
3.3.4 Prezenca e personave të paautorizuar në ambientet brenda dhe jashtë QV-ve.....	33
3.3.5 Zgjedhësit që nuk votojnë vetë.....	34
3.3.6 Votimi familjar dhe fotografimi i votës	34
3.4 Votimi në QV të posaçme pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) .	35
4 Numërimi i votave	36



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

4.1	Respektimi i procedurave ligjore gjatë numërimit.....	37
4.2	Klima në VNV dhe prania e personave të paautorizuar.....	41
4.3	Miratimi i tabelave përmbledhëse	41
4.4	Procedura e ankimit pranë KAS	42
REKOMANDIME:		42



Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është organizatë jofitimprurëse e themeluar më 16 Dhjetor të vitit 1990. Misioni i KShH-së është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Nëpërmjet monitorimit të procesit zgjedhor parlamentar, KShH ka synuar rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve kompetente për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, me pjesëmarrje të gjerë qytetare dhe përfaqësim dinjitoz nga kandidatët në përputhje me Kodin Zgjedhor (KZ) dhe legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, KShH ka ofruar kontributin e tij modest në drejtim të dërgjegjësimin të qytetarëve mbi rëndësinë e ushtrimit të së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur si një e drejtë themelore kushtetuese..

Me mbështetjen financiare të Ambasadës Gjermane në Shqipëri, KShH zbatoi nismën “Drejt një integriteti më të mirë të kandidatëve dhe zgjedhjeve të lira e të ndershme në 5 Bashki të vendit”. Në kuadër të kësaj nisme, me kontributin e 5 koordinatorëve lokalë të vendosur në zonat që janë në juridiksionin e Bashkive Malësi e Madhe, Dibër, Lezhë, Pogradec dhe Berat, KShH monitoroi procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor, gjatë muajve Mars – Prill 2021.

Për shkak të përhapjes së pandemisë globale Covid 19, Zgjedhjet Parlamentare 2021 nuk u realizuan në kushte të zakonshme, pasi qytetarët, përfaqësuesit e administratës zgjedhore dhe vëzhguesit ishin të detyruar që të respektonin masat e parashikuara në protokollin mjekësor të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik. Më tej, sikurse do të evidentohet përgjatë këtij raporti, këto masa nuk u zbatuan kryesisht gjatë fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore.

Data e zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit 2021, u dekretua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë më datë 6 Shtator të vitit të kaluar, 2020.

KShH akreditoi 63 vëzhguesish, 45 prej të cilëve u angazhuan në monitorimin e procesit të votimit në 100 qendra votimi (QV) dhe 18 vëzhgues u përfshinë në monitorimin e procesit të numërimit të votave në 9 vende numërimi të votave (VNV). Vëzhguesit e KShH-së të akredituar nga KQZ nëpërmjet vendimit nr. 217, dt. 12.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve u pajisën me njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike, përgjatë 2 trajnimeve të dedikuara për ngritjen e kapaciteteve të tyre për monitorimin objektiv, profesional dhe cilësor të procesit zgjedhor. Reflektimi i të dhënave të monitoruara në terren u realizua prej tyre në pyetësorë të individualizuar për secilën fazë të monitorimit, pra atë të votimit dhe të numërimit të votave, në format hard copy (fizikisht) dhe online.

Monitorimi i KShH-së i cili u shtri në periudhën parazgjedhore, votimin si dhe numërimin e votave, ishte i pjesshëm për faktin se u mbuluan vetëm 100 Qendra Votimi nga 5199 që ishin gjithsej. U arrit pra të monitorohej vetëm 1.9% të numrit total të qendrave të votimit. Monitorimi i procesit të numërimit u shtri në 9 KZAZ nga 92 të tilla që janë në shkallë vendi (pra në 9.8% të tyre).

Pavarësisht se monitorimi i realizuar nga ana e vëzhguesve ishte i kufizuar për shkak të numrit të pakët të tyre, të dhënat e referuara prej tyre gjatë procesit të vëzhgimit në terren kanë shërbyer në evidentimin e disa çështjeve të rëndësishme, në përfundim të analizës së të cilave reflektohen sugjerime dhe rekomandime konkrete me natyrë përmirësuese për proceset e ardhshme zgjedhore.



Në përfundim të këtij procesi monitorimi dinamik, KShH falenderon të gjithë vëzhguesit dhe koordinatorët lokalë në 5 Bashkitë e vendit, për proaktivizmin, profesionalizmin, paanshmërinë dhe përkushtimin e tyre. Falenderojmë në mënyrë të veçantë stafin e KShH-së që kontribuan në zbatimin e kësaj nisme të rëndësishme, Qeverinë e Republikës Federale Gjermane si dhe Ambasadën e akredituar në vendin tonë, të cilët mbështetën financiarisht realizimin e veprimtarisë për monitorimin e këtij procesi zgjedhor.

1. Përmbledhje Ekzekutive

- 1.1.** Data e zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit 2021, u dekretua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në 6 Shtator të vitit të kaluar (2020). Zgjedhjet Parlamentare 2021 ishin të parat që testuan zbatimin në praktikë të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor. Këto ndryshime nuk u realizuan sipas praktikave të mira të Komisionit të Venecias, i cili sugjeron që *“elementet themelore të legjislacionit zgjedhor nuk duhet të jenë të hapur për ndryshime në më pak se një vit para zgjedhjeve”*. Me qëllim që në fazën e realizimit të ndryshimeve në KZ të përfshihej dhe opozita jashtëparlamentare, më 5 Qershor 2020 u krijua Këshilli Politik. Ky këshill arriti të rishikojë, ndryshojë dhe miratojë një sërë dispozitash të këtij Kodi, të cilat më vonë u miratuan nga Kuvendi. Gjithashtu, në mungesë të konsensusit të opozitës jashtëparlamentare, Kuvendi miratoi ndryshimin e sistemit zgjedhor në nenet 64 dhe 68 të Kushtetutës, që më vonë u pasuan me disa ndryshime të tjera në KZ. Vlen të përmendet se këto ndryshime, sidomos ato kushtetuese ishin të nxituara, jo gjithëpërfshirëse, në cënim të rekomandimeve të Komisionit të Venecias si dhe nuk adresuan tërësisht rekomandimet prioritare të OSBE/ODIHR-it.
- 1.2.** Për shkak të përhapjes së pandemisë globale Covid 19, më datë 13.04.2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratoi Protokollin “Lidhur me masat anti Covid-19 gjatë procesit zgjedhor dhe ditës së votimeve¹”, me qëllim marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit dhe mbrojtjen e shëndetit të zgjedhësve dhe aktorëve të përfshirë në këtë proces. Në mënyrë shqetësuese, gjatë fazës së fushatës zgjedhore nga ana e subjekteve politike, gjatë procesit të trajnimeve të administratës zgjedhore në nivel vendor, në ditën e votimit si dhe në vendet e numërimit të votave, KShH ka konstatuar se ka qenë i pamundur respektimi me rigorozitet i masave parandaluese anti Covid-19. Mosrespektimi i masave anti-covid gjatë proceseve të lidhura me mbarëvajtjen e zgjedhjeve (fushata, trajnime etj), si dhe mosmarrja e masave nga organet kompetente në rastet e shkeljeve, i vendosi shtetasit në kushte të pabarabarta, ndërkohë që e drejta për tubim ishte e kufizuar dhe nuk lejohej grumbullimi i më shumë se 10 personave në ambiente të mbyllura apo të hapura.
- 1.3.** Mgjithsë në KZ parashikohej edhe garantimi i të drejtës për të votuar edhe të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, kjo nuk u realizua, në mungesë të një vendimmarrje të arsyetuar nga KQZ. I njëjti kufizim u vendos edhe ndaj shtetasve të infektuar dhe të karantinuar si pasojë e pandemisë globale SARS-Covid19.
- 1.4.** Komisioni i ri Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) u ngrit në Tetor të vitit 2020, pra gati 6 muaj para datës së zgjedhjeve. Ky institucion i nivelit më të lartë të administrimit zgjedhor, në kuadër të reformës zgjedhore, pësoi ndryshime si përbërje dhe si strukturë, në krahasim me KQZ e mëparshme. Shqyrtimi i kandidaturave nga ana e Kuvendit, për anëtar në organet drejtuese të tij u krye në një kohë shumë të shpejtë dhe nuk garantoj një proces krejtësisht meritokratik si dhe konsultim me grupet e interesit për kandidaturat e paraqitura. Ngritja me vonesë e këtij institucioni bëri që KQZ të punojnë në kushtet e një mbingarkese, sa i takon administrimit të procesit zgjedhor.
- 1.5.** Nga të dhënat zyrtare të regjistrit elektronik të publikuara në faqen e KQZ rezulton se fillimisht

¹ <https://ata.gov.al/2021/04/20/publikohet-protokolli-i-masave-antikovid-per-procesin-zgjedhor-maskat-te-detyrueshme/>

46 parti politike u regjistruan për të garuar për Zgjedhjet Parlamentare Prill 2021, si dhe 3 koalicione, në ndryshim nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017 gjatë të cilave nuk u regjistrua asnjë koalicion zgjedhor. Pas përfundimit të procesit të verifikimit të listave shumë emërore u mor vendim për regjistrimin e 12 subjekteve zgjedhore dhe 5 kandidatëve të pavarur.

- 1.6.** Ekstraktet e përbërësve zgjedhore dhe listat përfundimtare të zgjedhësve, sipas të dhënave të referuara nga vëzhguesit e KShH-së, rezultojnë ato janë hartuar dhe publikuar në respektim të procedurave ligjore të parashikuara në nenin 51, pika 4 të Kodit Zgjedhor, në të 5 Bashkitë objekt monitorimi. Por në Bashkitë Pogradec dhe Lezhë është raportuar se aksesit i qytetarëve për t'u njohur me to ka qenë i kufizuar (për shkak të vendosjes së tyre në ambiente të papërshtatshme etj).
- 1.7.** Gjatë monitorimeve të realizuara në 5 Bashkitë e vendit ka rezultuar se procesi i njoftimit me shkrim të zgjedhësve në banesa nuk është realizuar, pavarësisht se fondi rezulton t'i jetë akorduar Njësive të Qeverisjes Vendore nga ana e Ministrisë së Brendshme. Lidhur me mospërbushjen e këtij detyrimi, Bashkitë nuk kanë referuar argumentat përkatës.
- 1.8.** Nga 9 KZAZ-të e monitoruara nga KShH në 5 Bashkitë e vendit, rezulton se veprimtaria e KZAZ nr. 69 pranë Bashkisë Pogradec ka filluar me vonesë, tej afateve ligjore dhe vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Selitë e të gjitha KZAZ-ve objekt monitorimi kanë qenë të vendosura në ambiente publike. Anëtarësia e KZAZ-ve të monitoruara ka qenë në përputhje me parashikimin ligjor në nenin 29 KZ, ndërkohë që zevëndësime të anëtarëve janë vërejtur në Bashkitë Lezhë, Berat dhe Malësi e Madhe. Detyrimi ligjor për vendosjen e indikacioneve me emrat e anëtarëve/sekretarit dhe numrat e kontaktit, nuk është respektuar nga stafet e pjesës më të madhe të KZAZ-ve objekt monitorimi. Shkaqe justifikuese janë raportuar: mungesa e përcjelljes së indikacionit tip të ngjithshëm në derën e KZAZ, ose mungesa e vullnetit të anëtarëve për të ofruar detajet mbi emrat apo kontaktet e tyre.
- 1.9.** Anëtarët e KZAZ-ve janë trajnuar në muajin Mars 2021, rreth 2 muaj me vonesë nga data kur duhej të ishin ngritur dhe mbledhur.² Vëzhguesit raportojnë për mungesa të prezencës së përfaqësuesve të KZAZ-ve gjatë orarit zyrtar të caktuar për funksionimin e tyre. Kontakti me ta është realizuar vetëm pas njoftimit nga vëzhguesit. Vendimet e KZAZ-ve shfaqim mangësi procedurale në drejtim të zbardhjes së mbledhjeve apo vendimeve në Librin e Protokollit, apo firmosjes e vulosjes se tyre. Në kundërshtim me pikat 5 dhe 6 të nenit 22 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 40/2020, sekretarët/anëtarët e KZAZ-ve kanë mbajtur shënime të punimeve të mbledhjeve dhe vendimmarrjeve në blloqe personale shënimesh.
- 1.10.** Vëzhguesit raportojnë për vonesë në ngritjen e disa KQV-ve si rrjedhojë e kohës së gjatë që i është dashur subjekteve politike për të korrigjuar të metat e konstatuara nga ana e KZAZ dhe kësaj të fundit për të marrë vendim përfundimtar për emërimin e anëtarëve të KQV. Në përputhje me nenin 62, pika 2, ngritja e QV të posaçme në institucionet e burgjeve dhe ato të shëndetit publik, rezulton të jetë realizuar në Bashkinë Lezhë për IEVP Shënkoll dhe IEVP Reç, Bashkia Malësi e Madhe. Vonesa janë konstatuar dhe në trajnimin e anëtarëve të KQV-ve, i cili është realizuar nga dt. 18 – 23 Prill 2021. Pjesëmarrja në këto trajnime konstatohet e ulët në disa prej Bashkive të monitoruara, si dhe jo e përfaqësuar për disa prej anëtarëve të

² Sipas vendimit nr. 15/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, KZAZ duhet të realizonin mbledhjen e parë më dt.28-29 Janar.

caktuar nga subjektet zgjedhore.

- 1.11.** Vendndodhja e QV nr. 07091, në Shëngjin pjesë e Bashkisë Lezhë është ndryshuar *de facto*, pa një vendimmarrje konkrete nga ana e KQZ-së. Ndryshimi i kësaj vendndodhje nga shkolla në Shëngjin, pranë subjektit privat Colombo, ka shkaktuar konfuzion tek votuesit në ditën e zgjedhjeve.
- 1.12.** Faktikisht fushata zgjedhore rezulton se ka filluar shumë kohë më parë afatit një muaj të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor. Shqetësues është fakti që kjo fushatë është realizuar në një klimë tepër të polarizuar politike si dhe është shoqëruar me elementë të gjuhës së urrejtjes, me elementë të diskriminimit të gjinisë femërore apo në cenim të dinjitetit të kandidatëve të propozuar nga subjektet zgjedhore “kundërshtarë”. Evidentohet organizimi i takimeve informale në ambiente të mbyllura dhe në cënim të protokolleve dhe masave anti Covid 19. Ndërkohë janë referuar nga ana e koordinatorëve lokalë “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, nga ana e Bashkive Pogradec, Dibër dhe Malësi e Madhe, gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Gjatë fushatës zgjedhore, një ndër problematikat e hasura ka qënë edhe përfshirja e punonjësve të autoriteteve të ndryshme të administratës publike gjatë orarit zyrtar të punës në mbledhjet apo takimet e subjekteve zgjedhore në kundërshtim me nenin 91 të KZ.
- 1.13.** Procesi parazgjedhor është shoqëruar nga disa incidente dhe akte të dhunshme të ndërmarra ndërmjet kundërshtarëve politik, të cilat u përshkallëzuan disa ditë para ditës së votimit. Gjithashtu, janë evidentuar raste të depozitimit të një kallëzimi pranë SPAK ndaj zyrtarëve lokalë në Berat nën akuzën e “Korrupsionit pasiv në zgjedhje”, si dhe janë regjistruar procedime penale ndaj simpatizantëve të subjekteve zgjedhore në Bashkinë Dibër. Rreth 2 ditë pas zgjedhjeve, SPAK në një njoftim zyrtar për median informoi publikun mbi regjistrimin pranë kësaj Prokurorie të 33 procedimeve në kategorinë e veprave penale në fushën e zgjedhjeve.
- 1.14.** Pjesëmarrja zyrtare e votuesve në Zgjedhjet Parlamentare të dt.25 Prill 2021 rezulton 46.32%. Rreth 47.66% e zgjedhësve ishin të gjinisë femër. Gjatë procesit të Zgjedhjeve Parlamentare Prill 2021 rezulton se garuan në total 1841 kandidatë, nga të cilët 732 femra ose rreth 40% e tyre. Një faktor pozitiv që kontribuon për konsolidimin e sistemit demokratik është edhe përfaqësimi në organet e zgjedhura të gjinisë së nënpërfaqësuar. Kjo përqindje e kandidateve femra në këto zgjedhje parlamentare përmbushi kuotën gjinore të përcaktuar në nenin 67 pika 6 KZ.
- 1.15.** Vëzhguesit e KShH-së në 5 Bashkitë e monitoruara raportuan se punonjësit e Policisë së Shtetit vepruan në përputhje me ligjin dhe qëndruan në ambientet e jashtme të QV-ve dhe të VNV-ve. Mgjth, kjo situatë reflekton edhe faktin se administratës zgjedhore në nivel vendor nuk kanë kërkuar ndërhyrjen e forcave të Policisë së Shtetit për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në QV-të dhe VNV-të e monitoruara.
- 1.16.** Procesi i votimit u shoqërua nga një klimë e qetë, ndërkohë që prezencë e personave të paautorizuar brenda QV ose në ambientet e jashtme të tyre u vërejt gjerësisht në QV-të e monitoruara në disa prej Bashkive të vendit. Anëtarët e KQV-ve shfaqën mungesë njohurish

dhe u ngatërruan sa i takon diferencimit të ‘votimit familjar’ dhe ‘asistenca ofruar zgjedhësve që nuk mund të votojnë vetë’. Fenomeni i fotografimit të votës u vërejt edhe në këtë proces zgjedhor. Administrata zgjedhore u shfaq jo e unifikuar sa i takon referimit të këtyre rasteve pranë punonjësve të Policisë së Shtetit, ndërkohë që vërejtjet me shkrim të vëzhguesve të akredituar jo në të gjitha rastet u protokolluan sipas legjislacionit në fuqi.

- 1.17.** Procesi i numërimit të votave u realizua në një klimë jo të qetë, të zhurmshme, dhe me prezencë të shtuar të personave të paaautorizuar në ambientet e VNV-ve, të cilët ushtronin ndikim mbi anëtarët e GNV. Gjatë numërimit të votave tërhoqi vëmendjen fakti se numri i fletëve të votimit të pavlefshme ishte i lartë në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, si dhe u vërejt mungesë e unifikimit të praktikës së vlerësimit të votave si të vlefshme apo të pavlefshme nga grupet e numërimit të votave. Nga të dhënat zyrtare të publikuara në faqen e KQZ rezulton se rreth 83001 vota janë konstatuar të pavlefshme, nga 1662386 ose rreth 5% e numrit total të votave. Disa nga arsyet e pavlefshmërisë të fletëve të votimit lidhen me ndryshimin e sistemit zgjedhor, përmbajtja e fletës së votimit në të cilën kandidati u paraqit vetëm me numër, koha jo e mjaftueshme për ndërgjegjësimin në masë të zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, me gjithë kujdesin dhe angazhimin e treguar nga KQZ, etj. Gjatë monitorimit të procesit të numërimit të votave, u vërejtjen kontestime në masë të depozituara nga vëzhguesit e subjekteve politike në Bashkitë Dibër dhe Berat, për shkak të kalimit të shpejtë të fletëve të votimit në monitor apo mungesës së paqartësisë nga cilësia e monitorit. KZAZ kanë luajtur rol proaktiv në zgjidhjen e këtyre situatave.

2. PROCESI PARAZGJEDHOR NË 5 BASHKI TË VENDIT

2.1. Publikimi i ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë dhe i listave përfundimtare të zgjedhësve

Referuar nenit 50 të Kodit Zgjedhor (KZ), Ministri i Brendshëm i cili ka në varësi shërbimin e gjendjes civile është përgjegjës për nxjerrjen e urdhërave dhe udhëzimeve sa i takon drejtimit metodologjik të punës së zyrave të gjendjes civile dhe mbikqyrjes së procesit të hartimit të listave të zgjedhësve prej tyre.

Nëpërmjet Udhëzimit nr. 298, dt. 10.09.2020, Ministri i Brendshëm udhëzoi kryetarët e Bashkive, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, si dhe institucionet e tjera shtetërore, mbi procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Për shkak të ndryshimit që ka pësuar neni 46 pika 2 e Kodit Zgjedhor, sa i takon numrit të zgjedhësve në një zonë qendre votimi, Ministri i Brendshëm korrigjoi urdhërin e sipër përmendur duke iu përshtatur ndryshimeve ligjore.³ Në respektim të nenit 51, pika 4 të Kodit Zgjedhor, brenda datës 06.10.2020, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, printojnë ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve. Ekstraktet publikohen në mënyrë periodike jo më vonë se në datat 05.11.2020, 05.12.2020, 04.01.2021, 03.02.2021 dhe 05.03.2021. Data 16.03.2021 përfaqëson afatin përfundimtar në të cilin zyra e gjendjes civile duhet të printonte listën përfundimtare të zgjedhësve dhe ta firmoste për çdo QV, ndërsa dt. 21.03.2021, është afati ligjor i parashikuar për miratimin e listës nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe dërgimin prej tij pranë Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ).

Nga monitorimi i realizuar në 5 Bashkitë e vendit u konstatua **se përfaqësuesit e zyrave të gjendjes civile, e kanë pasur të pamundur që të provojnë nëpërmjet vënies në dispozicion të një procesverbali përcjelljen e këtyre listave në adresë të Kryetarit të Bashkisë.**

Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë rezultojnë të jenë publikuar në përputhje me parashikimet e nenit 51 pika 4 të KZ, pranë zyrave të gjendjes civile ose në ambientet e Njesisë Administrative. Të gjitha ekstraktet e përbërësve zgjedhorë rezultojnë të jenë nënshkruar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi në Bashkitë e Monitoruara.



Ndërkohë që dispozita e sipërcituar parashikon garantimin e aksesueshmërisë për publikun, në mënyrë që në çdo moment, qytetarët e interesuar të njihen me përmbajtjen e këtyre ekstrakteve. Nga monitorimi në terren rezulton se në disa

prej Bashkive të vendit, edhe në rastet e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë, por edhe të listave përfundimtare të zgjedhësve ka qenë i pamundur aksesimi i tyre pamor, nga qytetarët, pas orarit zyrtar të institucioneve ku ato janë afishuar (pas orës 16:30 ose gjatë fundjavës apo në ditë festash zyrtare). Psh: në rastin e monitorimit



³ Udhëzim nr. 6314, dt. 18.09.2020 “Ndreqje gabimi material. Link: <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2020/09/18/6314/277f00e1-0c1d-4976-be08-88b3fc474e17>

të listave përfundimtare të afishuara në QV nr. 0736, Shkolla “Gjergj Fishta”, Lagjia Besëlidhja (Lezhë), dhe ato të publikuara pranë Shkollës “Muharrem Çollaku” (Bashkia Pogradec), të cilat përveç se janë të vendosura në lartësi, duke e bërë të pamundur aksesin nga persona me lartësi mesatare trupore, gjithashtu ka qenë i pamundur leximi me sy të lirë për shkak të mungesave të qartësisë në printim.



Akresi i qytetarëve për t'u njohur me QV-të e vendosura në shkolla, paraqitet edhe më i kufizuar gjatë ditës, pasi mundësohet gjatë orarit të pushimit të procesit mësimor. Edhe kangjellat e dritareve në listat e publikuara në Shkollën “Gjergj Fishta” në Bashkinë Lezhë e vështirësojnë njohjen me këto lista.

Nga të dhënat e përcjella nga ana e koordinatorëve lokalë rezulton se bashkimi i QV-ve, në rastet kur numri i zgjedhësve ka qenë nën minimumin e parashikuar në nenin 62 KZ ka ndodhur përkatësisht në Bashkitë Dibër, Pogradec dhe në Malësinë e Madhe. Ngritja e QV të posaçme në institucionet e burgjeve dhe ato të shëndetit publik, rezulton të jetë realizuar në Bashkinë Lezhë për IEVP Shënkoll (QV nr. 0748 – 139 zgjedhës) dhe Bashkinë Berat (Njësia Administrative Otlak).⁴



Koordinatori lokal i KShH-së për Bashkinë Lezhë ka referuar me shqetësim vendndodhjen e QV nr. 07091. Duke iu referuar listës së publikuar nga KQZ, rezulton se kjo QV është e vendosur në ambient publik, përkatësisht në Shkollën “Shëngjin”.⁵ Gjatë monitorimit në terren të procesit të afishimit të listave përfundimtare të realizuar më dt.7 Prill 2021, është vërejtur se shkolla “Shëngjin” si pasojë e dëmtimeve të pësura nga tërmeti ishte në proces rikonstruksioni. Si rrjedhojë, listat rezultojnë të afishuara në një subjekt privat, hotel ‘Colombo’. Për këtë ndryshim të kësaj

QV, rezulton se KQZ nuk ka publikuar asnjë vendimmarrje.⁶ Për këtë çështje, KShH vuri në dijeni KQZ nëpërmjet shkresës nr. 284 prot., dt. 09.04.2021. KQZ me anë të shkresës nr. 296 prot., dt. 16.04.2021 na bëri me dije ndjekjen me prioritet të problematikave të ngritura dhe informimin e KShH-së, për masat që do të ndërmerren pas verifikimeve të kryera. **Por pavarësisht kësaj korrespondence institucionale rezulton se asnjë masë efektive nuk u ndërmor nga ana e KQZ në kuadër të mirë-administrimit të procesit zgjedhor. Në praktikë, kjo situatë shkaktoi konfuzion tek zgjedhësit ditën e votimit.**

2.2. Respektimi i të drejtës së diasporës shqiptare për të votuar gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2021

Një risi e rëndësishme e Kodit Zgjedhor sipas nenit 46, pika 3 të tij dhe dispozitave të tjera, është e drejta e diasporës shqiptare për të votuar jashtë vendit. Konkretisht, tri kriteret bazë për të

⁴ KZAZ e kësaj njësie nuk është objekt monitorimi nga ana e koordinatorit lokal për qarkun Berat.

⁵ http://kqz.gov.al/CEC_STRUKTURA/struktura.htm

⁶ Ky ndryshim i QV nuk gjendet i publikuar as në vendimin nr. 141, datë 15.03.2021 dhe as në vendimin nr. 120, datë 08.03.2021.

mundësuar ushtrimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë pjesë e diasporës shqiptare janë:

- a) të kenë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë,
- b) të kenë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe,
- c) të kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë.

KQZ u përfshi intensivisht që në fazat e para për finalizimin e suksesshëm të këtij procesi, më konkretisht në muajin Tetor 2020 u ngrit grupi i punës lidhur me mundësinë e votimit jashtë vendit.⁷ Administrata e KQZ më dt. 23 Mars 2021 ndau për konsultim me organizatat e shoqërisë civile dhe subjektet e interesuara, ndër të cilat KShH, projekt-aktin e natyrës projekt-vendim “Rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit për Zgjedhjet e Kuvendit”. Ky projekt-vendim nuk është finalizuar dhe as miratuar asnjëherë, dhe as nuk rezulton të jetë bërë pjesë e rendit të ditës të ndonjë prej mbledhjeve të KQZ.

Nga monitorimi i realizuar në terren rezulton se qëndrimi i punonjësve të Zyrave të Gjendjes Civile, për regjistrimin në RKGJC të vendbanimit të përhershëm të shtetasve shqiptarë jashtë Shqipërisë rezulton të jetë kontradiktor dhe jo i qartë. Disa prej punonjësve e referojnë si të porealizuar këtë proces, për shkak se detyrimi ligjor për regjistrimin e adresës nga ana e vetë qytetarëve në portalin qeveritar E-albania nuk është realizuar. Koordinatorët lokalë të KShH-së janë ndeshur edhe me opinione të punonjësve të tjerë, të cilët referojnë se shumë shtetas i janë drejtuar këtyre zyrave për regjistrim në regjistrin e gjendjes civile.

Nga një korrespondencë zyrtare e nisur me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile e informon Komisionerin se numri total i shtetasve shqiptarë me adresë jashtë territorit të RSH dhe me të drejtë vote, i kategorizuar sipas viteve 2009 – 2021, regjistruar në bazën e të dhënave të RKGJC-së rezulton të jetë 3613 shtetas shqiptarë, prej të cilëve, shumica dërrmuese rezulton të jetë regjistruar në vitin 2021, përkatësisht 2774 shtetas. Të dhënat e këtyre shtetasve janë të kategorizuar gjithashtu mbi bazë qarqesh dhe jo bashkish, duke rezultuar përkatësisht 131 shtetas të regjistruar në Qarkun Berat, 143 për Qarkun Dibër, 184 për Qarkun Lezhë, 368 për Qarkun Korçë dhe 191 për Qarkun Shkodër.⁸ Sipas nenit 24, pika 1 të Kodit Zgjedhor, ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në një intervistë për Emisionin Java në RTSH, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shprehet se “*Emigrantët nuk do të jetë e mundur të votojnë në këto zgjedhje. Janë rreth 3500 emigrantë që kanë deklaruar vendbanimin dhe as për ata nuk arritëm të gjenim një alternativë. Ishte varianti i postës, por sa kohë ne nuk kaluam hapin e parë atë të modaliteteve të regjistrimit të kërkesave nuk mund të bëhet*”.

Diaspora shqiptare nuk u përfshi në procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve të legjislativit, edhe pse interesat e tyre preken nga vendimmarrja e organit legjislativ. Pavarësisht se ka përfunduar procesi zgjedhor dhe ndodhemi në fazën paszgjedhore, nga ana e KQZ nuk rezulton të jetë miratuar ndonjë

⁷ Urdhër i Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, nr. 91, dt. 31.10.2020. Link: <http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/Urdher-nr.-91-date-31.10.2020-Per-ngritjen-e-grupit-te-punes-lidhur-me-mundesine-e-votimit-nga-jashte-vendit-per-zgjedhjet-per-Kuvend-te-dates-25-Prill-2021..pdf>

⁸ Shkresë nr. 690/1 prot., dt. 23.02.2021 “Kthim përgjigje” lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

akt administrativ që shpjegon për publikun vështirësitë e ndeshura për të konkretizuar votën e diasporës shqiptare nga vendbanimet e tyre të përhershme jashtë vendit.

2.2.1. Mohimi i të drejtës për të votuar i shtetasve të diagnostikuar dhe të karantinuar nga Covid-19

Në informacionin zyrtar të publikuar nga Instituti i Shëndetit Publik, rezulton se në datën e mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare 25 Prill 2021, 128 shtetas janë diagnostikuar si raste të reja të prekur nga virusi Sars-Covid 2, ndërkohë 149 qytetarë qëndronin të shtruar në spitale. Raste aktive në rang kombëtar rezultonin 22,431 shtetas⁹, të cilët referuar protokolleve mjekësore në fuqi duhet të qëndrojnë të karantinuar.

Lidhur me këtë çështje KQZ nuk ka shpallur asnjë vendim të arsyetuar, ndërkohë që Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet në daljen e tij publike rreth 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve ka referuar se *“me bazën ligjore aktuale të zgjedhjeve, të prekurit me COVID-19, që duhet të qëndrojnë të izoluar, nuk mund të votojnë. Për t’i hapur rrugën votimit të të infektuarve me COVID-19 duhen ndërmarrë ndryshime ligjore në Kuvend”*.¹⁰

Rreth 6 ditë përpara zgjedhjeve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Urdhërit nr. 219, dt. 19.04.2021, urdhëroi vetëkarantinimin e detyrueshëm për periudhën 14 ditore për shtetasit që udhëtojnë drejt vendit tonë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë. Shtetasit shqiptarë që banojnë në këto dy vende fqinje janë të shumtë, por as kësaj kategorie të shtetasve nuk iu krijuan kushtet për të ushtruar të drejtën e votës. Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor në vendin tonë dy janë kriteret kryesore për ngritjen e një QV të posaçme¹¹ në një spital ose institucion tjetër shëndetësor: në këtë institucion gjenden mbi 15 zgjedhës dhe spitali/institucioni shëndetësor duhet të pranojë pacientë për më shumë se tri ditë.¹²

Sipas Këshillit të Europës, ndërmjet vendeve europiane nuk u konstatua një trend i unifikuar, pasi u konstatuan disa prej vendeve që vendosën t’i realizonin zgjedhjet në kushtet e pandemisë globale duke marrë masa shtesë për parandalimin e Covid-19, por rezultuan dhe disa vende të tjera të cilat morën vendim për pezullimin/shtyrjen e proceseve zgjedhore. Në rast të shtyrjes, shqetësimet e publikut në lidhje me përpjekjet e perceptuara për zgjatjen e mandateve të atyre në detyrë "në mënyrë jo demokratike" duhet të merren parasysh seriozisht. Në të kundërt, vendimi për të mbajtur zgjedhje në rrethana të infektimit nga Covid-19 mund të kufizojë në mënyrë të konsiderueshme fushatat dhe të ulë pjesëmarrjen e votuesve, duke minuar kështu legjitimitetin e institucioneve të zgjedhura.¹³ Në nivel europian, Rekomandimi CM/Rec(2017)5 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare “Mbi standardet e votimit elektronik” mbetet një zgjidhje ideale që garanton respektim të parimeve të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, duke siguruar votimin nga shtetasit e ndodhur jo domosdoshmërisht fizikisht në QV. Praktika të tilla nëpërmjet ofrimit të mundësisë për të votuar shtetasve të prekur nga Covid-19 me anë të grupeve lëvizëse të përbëra nga staf i KQZ dhe staf shëndetësor u vërejtën në Kosovë.¹⁴ Ndërkohë në vende të tjera në të cilat janë mbajtur

⁹ <https://www.ishp.gov.al/komunikimi-i-perditshem-per-koronavirusin-25-prill-2021/>

¹⁰ <http://ata.gov.al/2021/02/25/votimi-i-te-prekurve-me-covid-19-celibashi-duhen-ndryshime-ligjore/>

¹¹ Neni 2 i Kodit Zgjedhor

¹² Neni 2 pika 2 dhe neni 62 pika 2 KZ

¹³ <https://www.coe.int/en/web/electoral-assistance/elections-and-covid-19>

¹⁴ <https://www.dw.com/sq/lvv-fitoi-m%C3%AB-s%C3%AB-shumti-vota-n%C3%AB-zgjedhjet-parlamentare->

procese zgjedhore është konstatuar mundësia e realizimit të votimit elektronik nëpërmjet platformave të posaçme ose në rrugë postare.

Në këndvështrimin e OSBE/ODIHR, në kontekstin e pandemisë, parimi i zgjedhjeve periodike duhet të balancohet kundrejt detyrimeve të tjera të shteteve, veçanërisht duke siguruar të drejtën për jetë dhe të drejtën për shëndetin dhe, në këtë mënyrë, duke marrë masa urgjente për të parandaluar përhapjen e pandemisë.¹⁵ Në rastin e vendit tonë, edhe pse ky balancim u synua të arrihej me anë të masave kufizuese, situata mund të menaxhohej më mirë në kohë, me qëllim që numri i shtetasve të privuar nga e drejta e votës për shkak se ishin të infektuar në Covid ose ata të ndodhur në vendet fqinje, të ishte sa më i vogël në numër. Në këtë drejtim, duke qenë se zgjedhjet u caktuan me Dekretin e Presidentit që në muajin Shtator të vitit të kaluar, Parlamenti mund të kishte vlerësuar nevojën për ndërhyrje në legjislacionin zgjedhor për të minimizuar këtë risk, por në fakt nuk e bëri.

2.3.Njoftimi me shkrim i zgjedhësve

Sipas nenit 52 KZ, deri më datë 06.12.2021, kryetarët e njësive të qeverisjes vendore duhet të merrnin masa për realizimin e procedurës së njoftimit me shkrim të zgjedhësve. Nëpërmjet kësaj procedure, e cila ka një impakt të drejtpërdrejtë në informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, zgjedhësit duhet të ishin të informuar lidhur me qendrën e votimit, vendndodhjen dhe adresën e saj, si dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve.

Pas realizimit të një misioni monitorimi në terren në 5 Bashkitë respektive, rezultoi se njoftimi i shtetasve me shkrim pranë banesës së tyre ishte një detyrim i pazbatuar plotësisht. Gjithashtu, bazuar në përgjigjet e përcjella nga ana e institucioneve vendore, njoftimi me shkrim i zgjedhësve nuk rezulton të ketë përfunduar, pavarësisht afatit ligjor dhe alokimit të fondit përkatës nga Ministria e Brendshme. Qytetarët me të cilët janë realizuar intervista nga koordinatorët lokalë të KShH-së pretendojnë se vetëm në formë verbale janë njoftuar nga ana e administratorëve të lagjes, por asnjë prej tyre nuk është njohur me një format të shkruar.

KShH e vlerëson si të nevojshme respektimin e këtij detyrimi të rëndësishëm ligjor si dhe sugjeron marrjen e masave për njoftimin me shkrim të zgjedhësve në banesa edhe jashtë afatit ligjor. KShH e shikon të nevojshme të theksojë se ndërsa aksesimi për t'u njohur me listat e shpallura të zgjedhësve është një e drejtë, njoftimi zyrtar në banesat e tyre është detyrim ligjor.

2.4.Regjistrimi i Subjekteve Zgjedhore

Regjistrimi i partive politike sipas nenit 64 pika 1 të KZ duhet të përfundonte më dt. 15.02.2021, ndërsa afati për regjistrimin e koalicioneve përfundoi më dt. 25.02.2021. Nga të dhënat zyrtare të regjistrimit elektronik të publikuara në faqen e KQZ-së rezulton se fillimisht 46 parti politike u regjistruan për të garuar për Zgjedhjet Parlamentare Prill 2021, si dhe 3 koalicione, në ndryshim nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2017 gjatë të cilave nuk u regjistrua asnjë koalicion zgjedhor. Nga ana e subjekteve zgjedhore u respektuan afatet e lartpërmendura për regjistrimin si parti

[n%C3%AB-kosov%C3%AB/a-56568000](https://www.osce.org/files/f/documents/e/c/457567_0.pdf)

¹⁵ OSCE Human Dimension Commitments and State Responses to the Covid-19 Pandemic, f. 80. Link: https://www.osce.org/files/f/documents/e/c/457567_0.pdf

politike dhe koalicion zgjedhor.¹⁶ Parë në këndvështrim krahasimor me Zgjedhjet Parlamentare 2017, rezulton se gjatë zgjedhjeve të vitit 2021, garuan 3 parti më pak.¹⁷

Jo më vonë se data 8 Mars 2021, partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore ose koalicionet zgjedhore duhet të depozitonin pranë KQZ-së listën shumëemërore të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore.¹⁸ Në kuadër të verifikimit të listave shumë emërore të kandidatëve nga ana e administratës së tij, KQZ mori vendim për kthimin për korrigjim të dokumentacionit¹⁹ të listave shumë emërore të depozituara në 13 raste.

Kryesisht arsyet e këtyre vendimmarrjeve janë mungesa e plotësimeve në formularët e vetëdeklarimit nga ana e kandidatëve, mosrespektim i kuotës gjinore ose tejkalim i numrit të kandidatëve etj. Subjektet politike të regjistruara depozituan listat shumëemërore të kandidatëve të korrigjuara dhe KQZ mori vendim në 12 raste për miratimin e listave shumëemërore. Procesi i miratimit të listave nga data e depozitimit të tyre prej subjekteve politike, i mori KQZ-së rreth 6 ditë kohë. Ndërkohë në këtë proces zgjedhor parlamentar rezultoi përfshirja e 5 kandidatëve të pavarur,²⁰ si rrjedhojë subjektet zgjedhore që garuan në këtë proces ishin 17 subjekte.

Partia “Aleanca Kombëtare” iu drejtua Kolegjit Zgjedhor me kërkesën për “Detyrimin e KQZ-së për regjistrimin e subjektit politik Partia Aleanca Kombëtare në Zgjedhjet Parlamentare të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Sipas çështjes objekt shqyrtimi, duke qenë se subjekti politik i regjistruar nuk ka paraqitur dokument provues për zotërimin e 1 mandati në Kuvend ose paraqitjen e listave mbështetëse me jo më pak se 5000 zgjedhës në shkallë kombëtare, KQZ ka vendosur refuzimin e listave shumëemërore të depozituara, pasi të metat e konstatuara nuk janë plotësuar brenda afateve ligjore. Kjo vendimmarrje e KQZ nuk është ankimuar pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS). Mos ezaurimi i rrugës së ankimit administrativ u bë shkak për pushimin e gjyqimit të çështjes nga ana e Kolegjit Zgjedhor.²¹

Gjatë procesit të Zgjedhjeve Parlamentare Prill 2021 garuan në total 1841 kandidatë, nga të cilët 732 femra ose rreth 40%. Kjo përqindje e kandidateve femra përmbushi kuotën gjinore të përcaktuar në nenin 67 pika 6 KZ.

Në 5 Bashkitë objekt monitorimi, gjinia femërore nuk duket se ka zgjedhur t’i drejtohet në masë QV në ditën e zgjedhjeve, duke rritur riskun e përfaqësimit nga kandidate të së njëjtës gjini me zgjedhësit. Në total në rang kombëtar rezulton se rreth 48.22% e zgjedhëseve të gjinisë femërore kanë ushtruar të drejtën kushtetuese për të zgjedhur. Më konkretisht në 5 Bashkitë objekt monitorimi rezulton se:

1

¹⁶ <http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/Regjistri-parti-koalicion-2021.pdf>


¹⁷ Në Zgjedhjet Parlamentare 2017 rezultojnë garuese 49 parti politike http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/170526-regjistrim_parti_2017.pdf

¹⁸ Neni 67 i Kodit Zgjedhor

¹⁹ Përmbajtja e dokumentacionit është e parashikuar në udhëzimin nr. 01, dt. 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.


²⁰ Elton Debreshi; Iljaz Shehu; Kreshnik Merxhani; Boiken Abazi dhe Pal Shkambi.

²¹ Vendim nr. 7, dt. 12.04.2021, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor Tiranë.



Nga të dhënat rezultojnë se në Bashkinë Malësi e Madhe vërehet një numër i ulët i votueseve femra në raport me numrin e zgjedhësve të gjinisë femërore pjesë e listave të zgjedhësve në këtë Bashki. Përkatësisht rezultojnë se vetëm 31% e femrave të regjistruara si zgjedhëse, votuan efektivisht në këto zgjedhje. Numri më i lartë i votueseve femra në raport me numrin e zgjedhësve të së njëjtës

gjini të regjistruara në listat zgjedhore rezultojnë të jetë shënuar në Bashkinë Diber (rreth 54%). Pjesëmarrja e votuesve në këto zgjedhje ishte në masën 46.23%, e cila pasqyron një pjesëmarrje të kënaqshme të qytetarëve që tregojnë interesin e tyre në procesin zgjedhor dhe ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur. Parë në analizë krahasimore me Zgjedhjet Parlamentare 2017, ku pjesëmarrja e qytetarëve shënoi 46.75%, vlerësojmë mbajtjen parasysh edhe të shtimit të numrit të zgjedhësve në rang kombëtar, në listën e zgjedhësve të vitit 2021, e cila kishte rreth 136,545 votues më shumë se lista e vitit 2017.²²



Gjatë procesit parazgjedhor, listat shumë emërore ishin objekt gjykimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, në kuadër të depozitimit të kërkesës nga PS, pas ezaurimit të ankimit administrativ. Kjo ankese drejtohej ndaj listave shumëemërore të Koalicionit PD-AN, të cilat pas verifikimit nga ana e administratës së KQZ janë rikthyer për korrigjim, sepse tejkalonin numrin e kandidatëve të kërkuar nga neni 67 pika 4 KZ.²³ Ndaj kësaj vendimmarrje subjekti zgjedhor përkatës nuk ka ushtruar ankim, por ka riparaqitur lista të reja, të cilat janë miratuar nga ana e Komisionerit.²⁴ Ndaj kësaj vendimmarrje është ushtruar e drejta e ankimit nga koalicioni PD-AN, dhe KAS ka vendosur pranimin e kërkesës ankimore dhe ndryshimin e vendimit duke disponuar detyrimin për Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për të regjistruar listat shumëemërore, siç janë depozituar në fillim (më dt. 16.03.2021).²⁵ Krahas logjikës së ndryshme aritmetike dhe argumentimit të ndryshëm terminologjik të nenit 67 pika 4 KZ nga ana e KAS në raport me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, KAS argumenton se “Komisioneri nuk ka tagra për të ndërhyrë në përmbajtjen e listës, për ta modifikuar atë, qoftë sipas vullnetit të tij, qoftë sipas vullnetit të ligjit. Lista është vullnet sovran i subjektit dhe i kandidatëve që pranojnë kandidimin. Edhe detyrimi për plotësimin

²² Në vitin 2021 numri i zgjedhësve është 3,588,869, ndërkohë në vitin 2017 numri i zgjedhësve ka qenë 3,452,324.

²³ Vendim nr. 131, dt. 10.03.2021 të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet

²⁴ Vendim nr. 156, dt. 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet

²⁵ Vendim nr. 9, dt. 23.03.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve

e kushteve është detyrim i subjektit”. Por ky argumentim i KAS dhe Koalicionit PD-AN nuk u mbështet nga ana e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Sipas vendimmarrjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, terminologjia e përdorur në nenin 67/4 KZ nuk tregon numrin minimal të kandidatëve në listën shumëemërore, por tregon se sa faktikisht duhet të jetë ky numër. Në analizë të këtij vendimi rezultojnë se:

- Numri i kandidatëve në listën shumëemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore;²⁶
- Kur numri i mandateve është i plotëpjesëtueshëm me numrin 3, atëherë nuk është e nevojshme shtesë (+2) në numrin e kandidatëve;
- Në rast se numri i mandateve nuk është i plotëpjesëtueshëm me numrin 3, atëherë shtohet (+1) në mënyrë që të gjenerohet një shifër e plotëpjesëtueshme me numrin 3. Në rast se dhe pas këtij veprimi aritmetik nuk arrihet ky plotëpjesëtim, atëherë i shtohet (+2).²⁷

Sa më sipër, kërkesë-padia e paraqitur nga ana e PS u pranua duke shfuqizuar vendimmarrjen e dhënë nga KAS, dhe duke lënë në fuqi atë të dhënë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që reduktonte listat shumë-emërore të kandidatëve të depozituara nga koalicioni PD-AN.

Një tjetër element, për të cilin KShH ka reaguar publikisht në muajin Tetor 2020 është ‘e drejta e kandidimit që ju është njohur kryetarit të partisë apo të partisë udhëheqëse të koalicionit, si deputet deri në katër zona zgjedhore’. Në këndvështrimin e ekspertëve të KShH-së, shtesa bërë nenit 67 KZ bie ndesh me parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të parashikuara në nenet 18 të Kushtetutës dhe 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky problem është trajtuar edhe në Raportin e OSBE/ODIHR të 14 Shtatorit 2009, ku midis të tjerave thuhet se “*Kodi Zgjedhor vazhdon të ketë dispozita të paqarta dhe të mjegullta*”.²⁸

2.5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor, në kuadër të reformës zgjedhore, përfshinë ndër të tjerash krijimin e një KQZ-je të re, e cila pësoi ndryshime të ndjeshme sa i takon organizimit, përbërjes, formulës së përzgjedhjes së anëtarëve të organeve drejtuese, por edhe detyrave shtesë që ju caktuan në raport me KQZ-në e mëparshme. Gjithashtu, këto ndryshime përfshinë edhe përmirësime në legjislacionin për financimin elektoral dhe reklamat, parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë elektorale, forcim të dispozitave lidhur me kuotat gjinore, përfshirjen e teknologjisë në zgjedhje, votën e emigrantëve të diasporës, etj.

Ndryshimet e dakordësuara në paktin e dt.5 Qershor të Këshillit Politik dhe të miratuara nga Kuvendi në dt.23 Korrik, nuk trajtuan disa probleme të tjera të rëndësishme, siç ishin reformimi i legjislacionit mbi partitë politike, depolitizimin e organeve të administrimit zgjedhor, financimin e subjekteve zgjedhore si dhe nuk ju nënshtruan një konsultimi me grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile. Ndryshimet kushtetuese që i hapën rrugë ndryshimit të sistemit zgjedhor u kryen në një hark shumë të shkurtër kohor dhe konsultimi me organizatat e shoqërisë civile kishte kryesisht karakter formal. Në zbatim të amendamenteve Kushtetuese, në datë 5 Tetor

²⁶ Numri i mandateve për zonë zgjedhore përcaktohet në vendimin nr. 7, dt. 11.12.2020 të Komisionit Rregullator

²⁷ Parag. 16, vendim nr. 3, dt. 29.03.2021 Kolegji Zgjedhor Gjyqësor Tiranë.

²⁸ Neni 26 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Protokollin 12 i Këshillit të Europës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, paragrafi 76 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së.


2020, Kuvendi miratoi paketën e dytë të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, dispozitat e të cilës kokretizojnë dhe detajojnë ndryshimet e lidhura me sistemin zgjedhor. Kjo paketë ligjore nuk ju nënshtrua as formalisht asnjë konsultimi me publikun dhe organizatat e shoqërisë civile.

Në fillim të Tetorit 2020 u emëruan funksionarët e organeve drejtuese të KQZ-së së re (Komisioneri dhe Zv.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator dhe Këshilli i Ankesave dhe Sanksioneve). Ngritja e KQZ-së së re, në një hark kohor prej më pak se 7 muajsh nga data e zgjedhjeve, u pasua me njëmbingarkesë të këtij institucioni të rëndësishëm që administron procesin zgjedhor në nivelin më të lartë, duke bërë që konsultimi i projekt-akteve të ndryshme me aktorë të interesuar, përfshirë shoqërinë civile, të realizohet në afate të ngushta dhe të mos mundësojë ofrimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve të një natyre cilësore.

KShH ka monitoruar online, në mënyrë të pjesshme, veprimtarinë e KQZ-së. KShH vlerëson marrjen e masave nga ana e këtij institucioni për ofrimin e informacionit për garantimin e transparencës ndaj publikut në një gjuhë të kuptueshme dhe të qartë.²⁹ Gjatë muajve Janar – Prill 2021, KQZ ka realizuar 62 mbledhje, përkatësisht 32 mbledhje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, 14 të Komisionit Rregullator dhe 16 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Vendimmarrjet e KQZ-së, parë në raport me publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve apo zbardhjes së vendimeve të arsyetuara me qëllim garantimin e transparencës për publikun e gjerë, konstatohen me vonesa të konsiderueshme, gjatë procesit parazgjedhor dhe atij zgjedhor. Vonesa përtej afatit të përcaktuar në nenin 34 të Vendimit nr. 01, datë 26.10.2020, konstatohen nga ana e Komisionit Rregullator. Gjithashtu, muajin e fundit është konstatuar një ndryshim në faqen zyrtare të KQZ-së, i cili e bën të pamundur monitorimin efektiv të datës konkrete të publikimit të vendimmarrjes në këtë faqe.



(Foto si ishte)



(Foto si është)

2.5.1. Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet

Bazuar në nenin 13 KZ, Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet në formën e një organi monokratik ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët. Gjatë procesit parazgjedhor, atij zgjedhor dhe paszgjedhor, KShH vëren se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka luajtur një rol pro-aktiv, duke informuar në mënyrë të vazhdueshme median dhe publikun.

KShH vëren se nga momenti i krijimit, Komisioneri ka dhënë 393 vendimmarrje (352 prej të cilave

²⁹ <http://kqz.gov.al/>

në vitin 2021),³⁰ 13 udhëzime dhe 9 urdhëra.³¹

Në mbyllje të procesit të votimit, KQZ i ka kujtuar subjekteve që të mos nxitojnë në shpalljen e rezultateve dhe të tregojnë respekt ndaj organeve të administratës zgjedhore që janë përgjegjëse për këtë proces. Gjithashtu, Komisioneri ka realizuar disa dalje publike lidhur me momentet kyç të administrimit të procesit parazgjedhor për identifikimin biometrik, grupet e punës për implementimin e teknologjisë në zgjedhje, votimin e emigrantëve, logjistikën zgjedhore, me verifikimin e formularëve të vetëdeklarimit, etj., si dhe gjatë ditës së votimit me qëllim sqarimin e opinionit publik se në cilat QV janë ndeshur probleme me PIE-të dhe si ka funksionuar votimi në këto QV. Komisioneri ka menaxhuar me kujdesin e nevojshëm, procesin e përshpejtimin të ritmit të numërimit të votave. Pozitiv është fakti që faqja zyrtare e KQZ-së ka mundur akses në kohë reale të informacionit lidhur me pjesëmarrjen e votuesve dhe rezultatet e numërimit të votave.

2.5.2. Komisioni Rregullator

Komisioni Rregullator i përbërë nga 5 anëtarë është ngritur nëpërmjet vendimit nr. 58/2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Nga koha krijimit, ky Komision ka miratuar 31 vendime dhe 2 udhëzime.³² Vendimmarrjet e Komisionit Rregullator rezultojnë unanime dhe të nënshkruara nga të gjithë anëtarët, ndërkohë që diskutimet e realizuara ndërmjet anëtarëve në mbledhjet përkatëse kanë qenë të një natyre konstruktive, të argumentuara, elemente që reflektojnë njohje të mirë të legjislacionit zgjedhor nga ana e anëtarëve.

2.5.3. Komisioni i Sanksioneve dhe Ankimimeve

KAS është një organ kolegjal, i përbërë nga 5 anëtarë, të cilët u zgjedhën nëpërmjet vendimit nr. 59/2020 të Kuvendit. Nga koha e krijimit, KAS disponoi me 55 vendimarrje, ndër të cilat 4 vendime të ndërmjetme.³³ Në ndryshim nga Komisioni Rregullator, vendimarrjet e KAS për çështje të diskutueshme nuk janë marrë me unanimitet. Në 14 vendime të KAS, konstatohet se anëtarët janë ndarë 2 me 3 ose vetëm 1 anëtar në pakicë, duke shoqëruar vendimmarrjen respektive me mendime paralele nga ana e anëtarëve të pakicës në nenin 21 pika 3 KZ. Duke qenë se kandidaturat për organet pjesë e KQZ janë paraqitur nëpërmjet vetë-ofrimit ose propozimit nga grupet parlamentare ose deputetët e veçantë,³⁴ KShH vlerëson se në vendimmarrjet ku anëtarët e KAS janë ndarë, evidentojnë mundësinë e influencave të natyrës politike.

2.6. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor

Kolegji Zgjedhor është ngritur bazuar në vendimin nr. 293, dt. 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përbëhet nga 8 gjyqtarë. Që nga momenti i krijimit të tij, rezulton se Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka disponuar me vendimarrje në 8 raste.

Dy (2) vendimet e para të marra nga ky kolegji i përkasin procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.³⁵ Ndërkohë 6 vendimmarrjet e tjera të Kolegjit kanë pasur si objekt çështje

³⁰ Nuk rezultojnë të publikuara vendimet nr. 194, nr. 239, nr. 267, nr. 268, dhe nr. 280.

³¹ <http://kqz.gov.al/akte-te-komisionerit/>

³² <http://kqz.gov.al/udhezime/>

³³ <http://kqz.gov.al/vendime-te-komisionit-te-ankimimeve-dhe-sanksioneve-2/>

³⁴ Neni 17 pika 2 KZ

³⁵ Vendim nr. 1, dt. 16.10.2020 dhe vendim nr. 1, dt. 18.02.2021.

të diskutueshme të ngritura nga ana e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore si: kundërshtimi i vendimmarrjes së Komisionerit për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV;³⁶ regjistrimin e subjekteve politike për të garuar në Zgjedhjet Parlamentare 2021;³⁷ ndryshimin e vendimmarrjes së Komisionerit për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t'u shpërndahen si paradhënie partive politike garuese në zgjedhjet parlamentare;³⁸ përmbajtja e fletës së votimit dhe logo që do të paraqitet në lidhje me një subjekt zgjedhor;³⁹ si dhe numri i kandidatëve në listat shumë emërore.^{40,41} Seancat gjyqësore pranë Kolegjit Zgjedhor janë realizuar të hapura, ndërkohë që janë transmetuar në kohë reale nga ana e medias.

2.7. Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve

Për Zgjedhjet Parlamentare Prill 2021 Komisioni Rregullator miratoi ngritjen e 92 ZAZ-ve, nëpërmjet vendimit nr. 06/2020. KShH monitoroi pjesërisht ngritjen dhe funksionimin e 8 Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në 5 Bashkitë objekt monitorimi.⁴² Ngritja e KZAZ-ve parashikohej të realizohej 90 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Nëpërmjet vendimit nr. 40/2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcaktoi partitë politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve. Referuar vendimit nr. 15/2021 të Komisionerit, datat 28-29 Janar u përcaktuan si data për ngritjen e KZAZ-ve dhe thirrjen e mbledhjes së parë. Nga 9 KZAZ-të e monitoruara në 5 Bashki të vendit rezultoi se KZAZ nr. 69 pranë Bashkisë Pogradec ka realizuar mbledhjen e parë më dt. 02/02/2021. Ndërkohë nga monitorimi i dt. 20.04.2021 pranë KZAZ nr. 13 Bashkia Lezhë, rezultoi se në librin e protokollit asnjë mbledhje nuk është dokumentuar.

Pavarësisht se sipas vendimmarrjes së Komisionerit 40/2020, subjekti zgjedhor PSD duhet të propozonte 1 anëtar për KZAZ me numër tek dhe çift, kjo e drejtë nuk u ezaurua nga ana e subjektit duke bërë që vakancat në 59 KZAZ të plotësohen nga propozimet e adresuara nga subjekti PS.

Anëtarësia e KZAZ-ve objekt monitorimi është në përputhje me parashikimin ligjor në nenin 29 të KZ, ndërkohë që zëvendësime të anëtarëve janë vërejtur gjatë muajve Mars-Prill 2021 në Bashkitë Lezhë, Berat, dhe Malësi e Madhe. Nga vendimarrjet e bëra publike në faqen zyrtare të KQZ-së rezultoi se disa prej subjekteve politike kanë kërkuar zëvendësimin e anëtarëve/sekretarëve të KZAZ-ve, 1 ditë para zgjedhjeve (KZAZ 66, Berat), ditën e zgjedhjeve (KZAZ 15, Lezhë) ose 1 ditë pas përmbylljes së procesit të votimit (KZAZ 65 dhe 66, Berat). Arsytet e zëvendësimeve dhe ndryshimeve të anëtarësisë nuk reflektohen në vendimarrjet e zbardhura të KQZ-së. KShH vlerëson se kjo mungesë qëndrueshmërie e anëtarëve/sekretarëve të KZAZ-ve cënon cilësinë e mirë administrimit të procesit zgjedhor në nivel vendor prej tyre, për shkak se anëtarët zëvendësues është e pamundur që të trajnohen brenda afateve aq të ngushta kohore.

Selitë e të gjitha KZAZ-ve objekt monitorimi kanë qenë të vendosura në ambiente publike,

³⁶ Vendim nr. 8, dt. 19.04.2021

³⁷ Vendim nr. 7, dt. 12.04.2021

³⁸ Vendim nr. 6, dt. 08.04.2021

³⁹ Vendim nr. 5, dt. 04.04.2021

⁴⁰ Vendim nr. 4, dt. 31.03.2021

⁴¹ Vendim nr. 3, dt. 29.03.2021

⁴² 1 KZAZ në Malësi të Madhe, 2 në Lezhë, 2 në Berat, 2 në Dibër dhe 1 në Pogradec.

lehtësisht të aksesueshme për qytetarët dhe subjektet e interesuara. Fillimisht nëpërmjet vendimit nr. 32, dt. 16.12.2020, Komisioneri përcaktoi njësitë administrative ku do të krijohen selitë e KZAZ, por selia e KZAZ nr. 66 në Njësinë Administrative Berat u ndryshua rreth 1 muaj më vonë.⁴³ Nga monitorimi i konstatuar në terren vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar se koha zyrtare e punës të KZAZ-ve, përkatësisht në intervalet gjatë ditës, 09.00 – 13.00 dhe 16.00 – 20.00, nuk është respektuar në masë prej tyre. Pavarësisht frymës së përgjithshme bashkëpunuese, akses i kufizuar ndaj vëzhguesve të akredituar është konstatuar në monitorimin e KZAZ nr. 13 në Bashkinë Lezhë.

Gjatë misionëve monitoruese të ndërmarra nga ana e koordinorit lokal në KZAZ nr. 12 dhe nr. 13 në Bashkinë Lezhë, gjatë muajit Mars 2021, u referua nga ana e anëtarëve pengesa e shkaktuar në mangësitë logjistike për shkak të mospajisjes me materiale kancelarie dhe mosfunksionimit efektiv. Sipas anëtarëve të KZAZ-ve të intervistuar, këto mangësi krijoheshin nga zëvendësimet e anëtarëve dhe vonesat në përcjelljen e materialeve prej KQZ-së.

2.7.1. Mbledhjet dhe vendimmarrjet e KZAZ-ve

Publikimi i anëtarësisë së KZAZ-së, numrit të KZAZ-së, numrin e telefonit dhe adresës elektronike në tabelën treguese në selinë e saj, janë elementë të rëndësishëm që garantojnë aksesin efektiv të qytetarëve apo palëve të interesuara. Në këtë drejtim, vëzhguesit raportojnë mangësi, si psh mospublikimi i indikacioneve lidhur mbi emrat e anëtarëve/sekretarit dhe numrat e kontaktit, në KZAZ nr. 12 dhe 13 (Bashkia Lezhë), nr. 66 (Bashkia Berat), nr. 69 (Bashkia Pogradec) dhe nr. 1 (Bashkia Malësi e Madhe).



Në pjesën më të madhe të KZAZ-ve të monitoruara, gjatë vizitave të para monitoruese në muajin Mars 2021 ka rezultuar i munguar edhe këndi i afishimit të vendimmarrjeve, duke e bërë të pamundur që qytetarët dhe publiku i interesuar të njihen me to.

Për shkak të situatës së Covid 19, anëtarët e KZAZ nr. 66 pranë Bashkisë Berat referojnë të kenë realizuar dhe disa mbledhje online nëpërmjet programit “Whatsapp”, të cilat nuk janë dokumentuar në librin e protokollit.

⁴³ Vendim nr. 13, dt. 25.01.2021, “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 16.12.2020 ‘Për caktimin e njësisë administrative ku do të krijohen selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021’”.

Lidhur me vendimmarrjen e KZAZ-ve janë evidentuar disa problematika. Kështu, psh: në Librin e Protokollit të mbajtur nga KZAZ nr. 13 Lezhë, në monitorimin e realizuar në muajin Prill 2021, nuk është gjetur asnjë shënim. Sekretarët/anëtarët e KZAZ-ve kanë pretenduar mbajtjen shënim të vendimmarrjeve në një bllok shënimesh personal, praktikë e cila në bie ndesh me pikat 5 dhe 6 të nenit 22 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 40/2020.



Me shqetësim konstatohet dhe situata e dokumentimit të vendimmarrjeve nga KZAZ nr. 12 Lezhë, pasi në Librin e Protokollit të mbledhjeve të kësaj të fundit janë hedhur disa nga mbledhjet të cilat shfaqin mangësi në firmosjen dhe vulosjen e vendimmarrjeve. Mangësi të njëjtë shfaqin edhe vendimet e vëna në dispozicion nga kjo KZAZ, ku mungojnë firmat e të gjithë anëtarëve si dhe vula.



Nga monitorimet e realizuara në 8 KZAZ-të në 5 Bashkitë objekt monitorimi konstatohet se zgjedhësit nuk kanë ushtruar të drejtën e parashikuar në nenin 34, shkronja g) KZ, për të depozituar kërkesa apo ankesa përsa i përket përditësimit apo saktësisht të të dhënave në listat zgjedhore. Mungesa e këtyre kërkesave dhe ankesave tregon gjithashtu një ndërveprim të dobët midis zgjedhësve dhe KZAZ-ve, çka mund të vijë edhe për faktin se niveli i publicitetit të veprimtarisë së KZAZ-ve është relativisht i ulët.

2.7.2. Anëtarët e KZAZ-ve që ushtrojnë funksione publike

Lidhur me veprimtarinë e KZAZ-ve objekt monitorimi, vëzhguesit afatgjatë të KShH-së kanë konstatuar se vendimmarrja mbi dhënien e lejes për angazhimin si anëtar të KZAZ-së, të shtetasve që ushtrojnë detyra publike ka qenë e ndryshme dhe jo e unifikuar.⁴⁴

Kërkesa për angazhimin rezulton të jetë depozituar nga subjekti zgjedhor ose nga vetë nëpunësi publik drejt institucionit përgjegjës punëdhënës. Në rastin e lejes aprovuar sekretaresh së KZAZ nr. 1 Malësi e Madhe rezulton se Zyra Vendore e ASHK-së ka referuar vendimmarrjen e saj në vendimin nr. 9, dt. 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërkohë leja miratuar specialistit të arsimit, kulturës dhe çështjeve sociale e turizmit pranë Këshillit të Qarkut Dibër është bazuar në legjislacionin e posaçëm për nënpunësin civil dhe nenin 29 pika 3 KZ.



Pavarësisht se në terren nuk janë referuar indicie konkrete mbi angazhimin e njëkohshëm të anëtarëve të KZAZ-së gjatë ushtrimit të funksioneve publike dhe atashimit si pjesë e administratës

⁴⁴ Sipas nenit 37 të ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”, pjesëmarrja në veprimtari politike duhet të jetë jashtë orarit zyrtar, në një kohë që përfshirja në angazhimin si anëtar i KZAZ-së realizohet në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 5, dt. 20.11.2020 të Komisionit Rregullator

zgjedhore, KShH vlerëson se vendimmarrjet e institucioneve publike duhet të unifikohen sa i përket bazës ligjore ndërkohë që duhet monitoruar në mënyrë strikte nga ana e KQZ-së respektimi i ndalimeve të përdorimit të burimeve njerëzore gjatë procesit zgjedhor.

2.8. Ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV)

Gjatë monitorimit të realizuar në 5 KQV-të në 5 Bashkitë e vendit, janë vërejtur vonesa në ngritjen e disa prej tyre, si rrjedhojë e kohës së gjatë që i është nevojitur subjekteve zgjedhore për të korrigjuar të metat e konstatuara nga ana e KZAZ-ve dhe këtyre të fundit për të marrë vendim përfundimtar. Data 25 Mars 2021 përlllogaritet si afat ligjor për depozitimin e listave me propozime nga ana e subjekteve politike, por në KZAZ nr. 18 (Bashkia Dibër) shkresa e fundit e përcjellë nga subjektet zgjedhore për plotësimin e të metave daton më 03.04.2021. Për rrjedhojë të vonesës në depozitimin e listës së propozimeve për anëtarë të KQV-ve, është vërejtur tejkalim i afatit për emërimin e anëtarëve nga ana e KZAZ-së së lartëpërmëndura, e cila sipas Kodit Zgjedhor duhet të merrte vendim brenda datës 05/04/2021.

Domosdoshmëria e njoftimit të KQZ-së mbi vendimmarrjen për ngritjen e KQV-së parashikohet në nenin 9 pika 5 KZ. Ndërkohë, KZAZ nr. 65 dhe nr. 66 (Bashkia Berat) pavarësisht ngritjes së KQV, prisnin në mënyrë të pa argumentuar përmbushjen e afatit maksimal 05.04.2021 për t'ja përcjellë KQZ.

2.8.1. Kualifikimi arsimor dhe trajnimi i anëtarëve të KQV-ve

Nga verifikimi i disa prej praktikave me dokumentacionet mbështetëse mbi anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve, rezulton se jo në të gjitha rastet është respektuar detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 2 të nenit 38 KZ për arsimin në lartë të Sekretarit të KQV-së. Sekretarët e KQV të ngritura nga KZAZ nr. 19 (Bashkia Dibër), KZAZ nr. 18 (Bashkia Bulqizë) dhe KZAZ nr. 1 (Malësi e Madhe) përgjithësisht janë me arsim të mesëm dhe jo me arsim të lartë.

Vlerësojmë se vonesat në ngritjen e KQV-ve të shkaktuara për shkak të mungesës së koherencës së realizimit të verifikimeve nga KZAZ, mbi përputhshmërinë e dokumentacionit të kandidimit dhe kushteve ligjore dhe plotësimit të të metave nga subjektet zgjedhore, kanë pasur një efekt domino dhe në trajnimin e anëtarëve të KQV-ve. Për shkak të përfshirjes së platformës online të raportimit nga ana e anëtarëve të KQV-ve dhe përdorimi i kamerave e identifikuesve biometrikë, KShH vlerëson se këto trajnime ishin të vonuara.



Referuar skemës së trajnimeve të ndarë nga përfaqësues të KQZ-së rezulton se në rang kombëtar ka filluar trajnimi i anëtarëve të KQV-ve nga dt. 18.04.2021, pra rreth 1 javë përpara datës së zgjedhjeve dhe ka përfunduar më dt. 23.04.2021. Gjatë trajnimeve të monitoruara nga ana e vëzhguesve të KShH-së është vërejtur pjesëmarrje në trajnim vetëm e anëtarëve të KQV-ve nga subjektet politike PS dhe PD, dhe mungesë e pjesëmarrjes së anëtarëve nga LSI. Pjesëmarrja konstatohet e ulët në disa Bashki, ku në trajnimin e realizuar më dt.

21.04.2021 në Bashkinë Malësi e Madhe vetëm 4 anëtarë morën pjesë.

2.9. Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) dhe trajnimi i tyre

Rreth datës 15 Prill 2021, në përputhje me nenin 95 KZ, duhet të ishin ngritur GNV-të me vendim të KZAZ-së. Nga monitorimet e realizuara në terren, rezulton se vetëm KZAZ nr. 66 në Bashkinë Berat ka marrë vendim për ngritjen e GNV-ve, me 1 ditë vonësë nga afati ligjor i përcaktuar. Propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve në Bashkitë e tjera, rezulton se janë depozituar nga ana e subjekteve zgjedhore, brenda afatit të parashikuar në dispozitën e sipërcituar. Anëtarët e GNV-ve kanë rezultuar të gjithë me arsim të lartë.

Me përjashtim të KZAZ nr. 1 në Bashkinë Malësi e Madhe, e cila e ka realizuar trajnimin e anëtarëve të GNV-ve rreth 3 ditë përpara zgjedhjeve, KQZ ka mundur trajnimin e anëtarëve të GNV-ve në 4 Bashkitë e tjera rreth 1 orë më përpara vendimmarrjes së hapjes së procesit të numërimit të votave. Një praktikë e tillë, e përsëritur në proceset zgjedhore të mëparshme, është jo vetëm e gabuar por ndikon tek performanca e anëtarëve të GNV-ve për të kryer me efikasitet detyrat e tyre, sipas procedurave ligjore. Për më tepër këto zgjedhje kishin dhe një specifikë që kërkonte trajnim paraprak, duke marrë parasysh se do të realizohej numërimi i votave jo vetëm për subjektin zgjedhor por edhe për kandidatët parapëlqyes. Vëzhguesit e KShH-së në 4 Bashkitë e sipër përmendura nuk janë lejuar që të aksesojnë dhe të ndjekin trajnimin që u është bërë anëtarëve të GNV-ve në ambientet e vendeve të numërimit të votave (VNV).

2.10. Fushata Zgjedhore

De facto, fushata zgjedhore rezulton se ka filluar shumë muaj para afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon fillimin zyrtar të fushatës një muaj para datës së zgjedhjeve. Shqetësues është fakti që kjo fushatë është realizuar në një klimë tepër të polarizuar politike si dhe është shoqëruar me elementë të gjuhës së urrejtjes, me elementë të diskriminimit të gjinisë femërore apo në cenim të dinjitetit të kandidatëve të propozuar nga subjektet zgjedhore ‘kundërshtarë’.

Nga monitorimi i realizuar, evidentohet organizimi i takimeve informale në ambiente të mbyllura dhe në cenim të protokolleve dhe masave anti Covid 19 të propozuara nga Komiteti i Teknik i Ekspertëve dhe të miratuara më pas me akte ligjore dhe nënligjore. Nisur nga situata shqetësuese në vend mbi njoftimet e përditshme të personave të infektuar me Covid-19, më dt. 29 Mars 2021, KShH i ka bërë thirrje publike partive politike dhe në veçanti çdo kandidati për deputet që në një situatë të tillë të tregohen të përmbytshëm dhe të mos mbivlerësojnë interesat e ngushta partiake.

2.10.1. Përdorimi i aseteve dhe administratës publike gjatë fushatës zgjedhore

Lidhur me mosrespektimin e ndalimeve ligjore për përdorimin e aseteve dhe administratës publike gjatë fushatës zgjedhore, qytetarët kanë luajtur një rol proaktiv në referimin e denoncimeve në adresë të koordinatorëve lokalë të KShH-së në 5 Bashkitë e vendit. Më konkretisht:



Bashkia Pogradec ka lëshuar leje infrastrukturore për punime në objektin “Rehabilitimi i rrugëve, shesheve e fasadave, blloku tek lagjia nr. 2”. Referuar lejes së infrastrukturës nr. 3893 prot., dt. 16.08.2020, afati është 16 muaj nga dita e fillimit të punimeve. Nga të dhënat e grumbulluara në terren, si dhe postimeve në faqen Facebook të Bashkisë Pogradec dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, punimet efektivisht kanë filluar në fillim të muajit Mars 2021, pra rreth 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve.

Problematika të keqpërdorimit të burimeve shtetërore u denoncuan edhe në Bashkinë Dibër, ku pretendohet se kryetari i Bashkisë Dibër, njëkohësisht kandidat për deputet në Zgjedhjet Parlamentare 2021, ka publikuar në rrjetin e tij social Facebook kopjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për rikonstruksionin e segmentit rrugor Perlat-Kurbnesh-Krej Lurë-Fushë Lurë.



Promovimi i kësaj marrëveshje të nënshkruar vlerësojmë se bie ndesh me nenet 91 e 92 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3, pika 1, të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Një rast tjetër është publikimi i furnizimit për herë të parë me ujë i fshatit Boriç i Vogël në Bashkinë Malësi e Madhe, i promovuar në faqen e Facebook të kandidatit T.M., si një angazhim primar i qeverisë. Promovimi i këtij investimi më dt. 16.04.2021 (rreth 9 ditë para zgjedhjeve) mendojmë se bie ndesh me nenet 91 e 92 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3, pika 1, të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit

Rregullator.

Gjatë fushatës zgjedhore, janë evidentuar raste të angazhimit të punonjësve të administratës publike në mbledhjet apo takimet e subjekteve zgjedhore. Përfshirja dhe shfrytëzimi i administratës dhe burimeve shtetërore për promovimin e subjekteve zgjedhore apo kandidatëve të caktuar është në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë pretendohet se është cënuar në Bashkinë Dibër, ku kandidati i subjektit politik PS Z. L.K., S.K. (Drejtor i Sigurimeve) dhe znj. A.Xh., kanë realizuar një takim elektorale në fshatin Pilafë të Njësisë Administrative Tomin në orën 12:00 të datës 13 Prill 2021. Ky takim nuk rezulton të jetë realizuar në ambiente të institucioneve publike, por me pjesëmarrjen e punonjësve të autoriteteve të ndryshme publike.





Gjithashtu, në Njësinë Administrative Slllovë të po kësaj Bashkie denoncohet të jenë mbajtur takime elektorale, ndërkohë që përfaqësues të administratës publike janë përfshirë në grumbullime elektorale brenda orarit zyrtar të punës, në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor.

Denoncimet e përcjella nga ana e koordinatorëve lokalë në 5 Bashkitë e vendit i janë përcjellë KQZ-së nëpërmjet shkresave zyrtare, ndërkohë që vetë KQZ na ka informuar mbi marrjen e masave për trajtimin e këtyre denoncimeve, por pa referuar rezultatet e hetimit administrativ dhe nëse ka patur ose jo sanksione konform Kodit Zgjedhor.

2.10.1.1. Qëndrimi i mbajtur nga KQZ mbi denoncimet e adresuara

Nëpërmjet vendimit nr. 233, dt. 14.04.2021 dhe vendimit nr. 385, dt. 08.06.2021, KQZ vendosi përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimeve të realizuara, duke mos gjetur cënim të dispozitave ligjore në fuqi nga ana e subjekteve objekt denoncimi. Më konkretisht në rastin e shtetases D.P. është argumentuar se “në muajin Mars 2021 subjekti është dorëhequr nga funksioni i anëtares së Asamblesë Kombëtare dhe si delegate e kongresit të Partisë Socialiste”.⁴⁵ Në rastin e denoncimit të dytë të depozituar, KQZ në vendimmarrjen e saj ndër të tjera argumentoi se duke iu referuar vendimit nr. 4/2021 të KAS “...Postimi në llogarinë e Facebook-ut nuk e bën veprimtarinë publike. Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon paragrafi 1 i nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias, që t’a konsiderojë veprimtarinë publike. Facebook-u nuk ka marrë pjesë në veprimtari sepse Facebook-u nuk është media që “merr pjesë”.⁴⁶


2.11.1 Afishimi i materialeve propagandistike

Kryetarët e Bashkive, sipas nenit 79 KZ përcaktojnë vendet publike në territorin e Bashkisë ku mund të afishohen materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore. Nga monitorimi i realizuar në 5 Bashkitë e vendit, konstatohet se **Bashkia Dibër nuk ka ka respektuar detyrimin ligjor për publikimin e vendimmarrjes për përcaktimin e vendeve të afishimit të materialeve propagandistike.**

⁴⁵ http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/210414_Vendim-233-Per-shqyrtimin-e-denoncimit-ndaj-Donika-Hysenaj-1.pdf

⁴⁶ <http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/Vendim- nr.385 dt.8.6.2021 Per-shqyrtimin-administrativ-te-denoncimit-ndaj-Dionis-Imeraj.pdf>

Krahas detyrimit ligjor për respektimin e distancës jo më të vogël se 300 m ndërmjet zyrës elektorale zgjedhore dhe organeve/vendeve të administratës zgjedhore, është konstatuar prezenca e një zyre zgjedhore në Bulevardin Republika Bashkia Berat jo më larg se 150 m pranë KZAZ nr. 65. E njëjta situatë vërehet në Pallatin e Kulturës pranë Bashkisë Pogradec e cila është kualifikuar si QV dhe ndodhet pranë zyrave elektorale të subjekteve zgjedhore.



Gjithashtu, raportohet se institucionet publike promovojnë në rrjetet sociale subjekte zgjedhore apo kandidatë të caktuar. Ndër të cilat dhe inagurimi i Maternitetit të ri të Lezhës, në të cilën morën pjesë kandidatë të caktuar të veshur me indikacione promocionale zgjedhore. Kjo situatë e konstatuar bie ndesh me nenin 91 KZ dhe vendimit nr. 6, datë 23/03/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

2.11.2 Incidentet gjatë fushatës parazgjedhore, si indicie për shitblerje të votave

Procesi parazgjedhor është shoqëruar nga incidente të shumta dhe akte të dhunshme të ndërmarrja ndërmjet përfaqësuesve apo mështetësve të subjekteve zgjedhore të kampeve “kundërshtarë”, të cilat u përshkallëzuan disa ditë para ditës së votimit.

Më 31.03.2021, disa të moshuar në Malësinë e Madhe u nxorën forcërisht nga ambientet e qendrës së vaksinimit, nën pretendimin se ambientet e kësaj qendre ishin përcaktuar për funksionimin e administratës zgjedhore.⁴⁷

Më dt. 10.04.2021, rreth 30 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila përfaqësohet nga kandidati i pavarur Iliaz Shehu në Bashkinë Lezhë, janë përfshirë në një protestë paqësore ndaj vendimmarrjes për ndërtimin e një hidrocentrali dhe fabrike uji në Thirrë.⁴⁸ Kjo protestë e konsideruar si e paligjshme nga ana e Policisë së Shtetit, është pasuar me vendimmarrjen e Policisë për gjobitjen e kandidatit për shkelje të masave anti-Covid 19.⁴⁹ Gjatë këtij muaji, në mungesë të një reference të qartë ligjore është konstatuar gjobitja e kandidatit të pavarur Elton Debreshi nga ana e Policisë së Bulqizës.⁵⁰ **Në monitorim të vazhdueshëm të grumbullimeve të realizuara nga subjektet e mëdha zgjedhore, KShH konstaton se vendimmarrje selektive për gjobitje të kësaj natyre, krijojnë pabarazi dhe premisa për trajtim diskriminues nga ana e autoriteteve shtetërore në cënimin e lirisë së tubimit paqësor, të parashikuar në nenin 47 të Kushtetutës, nenin 11 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe urdhërave nr. 633, dt. 17.11.2020 dhe nr. 183/1, dt. 08.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nga ana e dy kandidatëve të pavarur, subjekte ndaj të cilëve janë ndërmarrë masat administrative të sipërcituara, kjo praktikë është cilësuar si një tentativë për intimidim.**

⁴⁷ <https://politiko.al/ditari-i-maxhorances/rama-ne-malesi-te-madhe-perfaqesues-te-pd-donin-te-perzinin-i433000>

⁴⁸ <https://www.reporter.al/protesta-kunder-hec-ne-thirre-policia-ndalon-33-pjesemarres/>

⁴⁹ <https://www.reporter.al/policia-e-lezhes-akuzohet-se-gjobiti-kandidatin-e-pavarur-ne-menyre-selektive/>


⁵⁰ <https://www.reporter.al/policia-gjobiti-kandidatin-e-pavarur-por-ben-nje-sy-qorr-ndaj-partive-te-medha/>

Gjatë periudhës parazgjedhore ka patur raportime për raste të dyshuara të shitblerjes së votës apo vepra të tjera penale që cenojnë zgjedhjet e lira dhe demokratike. Kështu, më dt. 19.04.2021, në



orën 20:00 të mbrëmjes, në një denoncim të bërë live në faqen e Facebook të kandidatit për deputet T. A në Bashkinë Berat, i pretendonte se në një furgon gjendeshin përfaqësues të administratës zgjedhore dhe dyshohej për shpërndarje të paligjshme të produkteve ushqimore pjesë e rezervave të shtetit. Nga intervista e realizuar në terren nga koordinatori lokal i KShH me përfaqësues të Bashkisë Berat, u pretendua se përfaqësuesja e KZAZ nr. 66 prezente në furgon ka qenë e autorizuar nga ana e Bashkisë për realizimin e transportit të ndihmave

ushqimore nga salla e konferencave drejt magazinës së Drejtorisë Arsimore. Me tej, Prokuroria Berat ka përcjellë pranë SPAK kallëzimin e depozituar nga subjekti zgjedhor “PD” ndaj zyrtarëve lokalë nën akuzën e “Korrupsionit pasiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 K.Penal.



Rreth 3 ditë përpara zgjedhjeve, më dt. 21.04.2021, Drejtoria Vendore e Policisë Diber në njoftimin për media, informon se është realizuar arrestimi në flagrancë i 2 shtetasve për veprat penale ‘Korrupsioni aktiv në zgjedhje’ kryer në bashkëpunim dhe ‘Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore’. Një prej shtetasve i arrestuar rezulton i punësuar si jurist pranë Bashkisë Diber. Çështja është referuar pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Diber.

Në faqen zyrtare të SPAK, bëhet e ditur se 33 procedime penale janë nën hetim, lidhur me veprat penale në fushën e zgjedhjeve.⁵¹

KShH vlerëson se çështje të tilla kërkojnë një hetim të shpejtë, të gjithëanshëm dhe objektiv për të zbardhur dyshimet që rëndojnë ndaj autorëve të implikuar në krimet zgjedhore. Informimi me transparencë i publikut nga prokuroria për ecurinë e këtyre çështjeve, por pa zbuluar të dhënat hetimeve që mund të kompromentohen, është faktor i rëndësishëm për besimin e publikut në organet e drejtësisë.

3 Procesi i votimit

3.1 Heshtja Zgjedhore

Nga monitorimi i KZAZ-ve realizuar më datë 24 prill 2021, u vu re se heshtja zgjedhore është respektuar pjesërisht në Bashkitë e monitoruara. Shkelje të parashikimit të nenit 77 të KZ për heshtjen zgjedhore është evidentuar nga një kandidat për deputet në Bashkinë Diber, i cili u procedua penalisht me akuzën për veprën penale të parashikuar në nenin 222 K.P. “Thirrje për armatosje ose marrje të padrejtë të komandës”. Ndërkohë nuk ka asnjë vendim nga KQZ për gjobitjen e subjektit i cili ka thyer heshtjen zgjedhore, në zbatim të nenit 174 të KZ.

Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, vëzhguesit e KShH-së kanë takuar qytetarë në rrugë, për të

⁵¹ <https://spak.al/2021/04/27/njoftim-24/>

dëgjuar vlerësimet e tyre për klimën me të cilën janë shoqëruar zgjedhjet parlamentare 2021, kryesisht në Bashkitë Dibër, Pogradec, Malësi e Madhe, Berat dhe Lezhë. Nga rezultati i këtyre intervistave evidentohet se shumica e qytetarëve se do të marrin pjesë në ditën e votimit. Gjithashtu rreth 15% e personave (edhe pse ky kampion nuk është gjithëpërfshirës) kanë pohuar se atyre ose të afërmeve të tyre u janë premtuar të mira materiale në këmbim të votës, si dhe janë intimiduar për votimin e një partie/kandidati të caktuar. Perceptimi se zgjedhjet do të shoqërohen me incidente është vënë re tek një numër i konsiderueshëm qytetarësh të kontaktuar (rreth 60%). Fatmirësisht, një gjë e tillë ka qënë e minimizuar gjatë ditës së votimit.

3.2 Shpërndarja e materialeve zgjedhore nga KZAZ drejt KQV


Kodi Zgjedhor parashikon se KQZ-ja dërgon materialet zgjedhore në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve. Nga monitorimi i realizuar evidentohet se ky afat nuk është respektuar nga ana e KQZ-së, ndërkohë që anëtarët e KZAZ janë konstatuar të lodhur për shkak të qëndrimit zgjuar natën e ditës së shtunë, me qëllim marrjen e masave për përgatitjen e kutive të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit.

Neni 100 i KZ parashikon një afat 15 orë para hapjes së votimit për dërgimin e materialeve nga KZAZ-të përkatëse drejt KQV-ve nën juridiksionin e saj, afat i cili përkon me orën 16.00 të datës 24 prill. Ky afat për një pjesë të madhe të KZAZ-ve nuk është respektuar.⁵² Vonesat në përcjelljen e materialeve kanë qënë mes 1-5 orëve nga afati. Shkak është bërë kryesisht mungesa e koordinimit efektiv mes anëtarëve të KZAZ-ve, ndryshimet që ka pësuar anëtarësia e tyre, vonesat në emërimin dhe zëvendësimin e komisionerëve etj. Dërgimi i kamerave dhe Pajisjeve Elektronike të Identifikimit (PEI) është realizuar veçmas nga materialet e tjera, për shkak të veçorive të transportimit dhe instalimit, sipas udhëzimeve të veçanta të KQZ-së. Materialet zgjedhore janë përcjellë drejt KQV-ve me makina të autorizuar nga KQZ dhe me prezencën e Policisë së Shtetit.

3.3 Monitorimi i procesit të Votimit

Gjatë procesit të votimit, situata raportohet të ketë qënë e qetë dhe pa incidente, në ndryshim nga klima parazgjedhore, e cila ka patur një trend ashpërsues para ditës së heshtjes zgjedhore.

A u hap votimi për zgjedhësit në orën 7:00?
100 responses



Nga 100 QV të monitoruara⁵³ rezulton se në 56% të rasteve, QV është hapur në orën 07:00, në respektim të orarit të parashikuar në nenin 11 të KZ. Ndërkohë në 35% të rasteve anëtarët e KQV nuk rezulton të kenë respektuar këtë orar, për shkak të mosprezencës së operatorëve për vënien në funksion të sistemit PEI,

⁵² Konkretisht, shpërndarja nga KZAZ nr. 12 dhe nr. 13 në Lezhë pranë KQV-ve përkatëse ka përfunduar rreth orës 17.00-17.45, KZAZ nr. 1 në Malësinë e Madhe ka përfunduar procesin në orën 18.00, KZAZ nr 69 në Pogradec ka vijuar shpërndarjen deri në orët e vona të datës.

⁵³ **Bashkia Berat:** QV-3268, QV-32681, QV-3269, QV-32691, QV-3279, QV-3280, QV-3285, QV-3287, QV-32871, QV-3271. QV-3272, QV-3289, QV-32911, QV-32901, QV-3291, QV-3292, QV-3294, QV-32941, QV-3295, QV-32951, QV-3296, QV-3297.


Bashkia Pogradec: QV-3886, QV-38861, QV-3887, QV-3889, QV-38891, QV-3891, QV-38911, QV-38912, QV-3892, QV-3903, QV-39031, QV-3904, QV-3898, QV-38981, QV-3905, QV-39051, QV-3906, QV-38991, QV-3900,

mosparaqitjes së anëtarëve të KQV,⁵⁴ mungesë e procesverbalit të hapjes së procesit të votimit, ndërprerjes së energjisë elektrike⁵⁵ etj. Këto vonesa nuk kanë qenë të konsiderueshme, por i përkasin një harku kohor max 40 min. Rastet e evidentuara në masën 9% përkojnë me monitorimin QV-ve, të cilat kanë qenë lëvizëse për vëzhguesit, pra nuk janë monitoruar nga hapja e tyre deri në përfundim, por pjesërisht dhe në orare rastësore ose sipas indicjeve të dhëna nga media për incidente potenciale.

Anëtarët e KQV në 97% të rasteve rezultojnë se kishin ndarë në mënyrë proporcionale punën ndërmjet tyre, ku në të gjitha rastet, 1 anëtar ruante distancën fizike dhe këshillonte zgjedhësit për të respektuar masat anti Covid-19.

Pavarësisht këtij roli, protokoli “Lidhur me masat anti-Covid19 gjatë procesit zgjedhor dhe ditën e votimit” i miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Udhëzim nr. 11 dt. 24.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk është zbatuar rigorozisht në rang të 5 Bashkive. Më konkretisht, ka qenë e pamundur që të gjitha QV të jenë në katin e I-rë të ndërtesës, me dy dyer dhe me ajrosje të mjaftueshme, konform masave për ndalimin e përhapjes së Covid-19.


Tek anëtarët e KQV-ve a kishin ndarje pune?
100 responses



3.3.1 Sfidat e përdorimit të pajisjes elektronike PEI dhe parregullsitë e vërejtura si rrjedhojë e implementimit të teknologjisë

Përdorimi i sistemit PEI në këtë proces zgjedhor i ka gjetur jo shumë të përgatitur anëtarët e KQV-ve. Printimi i fletës në momentin e votimit dhe administrimi i kësaj flete prej tyre ka shkaktuar një sërë vonesash në procesin e votimit. Gjithashtu, në disa prej QV-ve kjo pajisje ka shfaqur problematika dhe është realizuar zëvendësimi i saj, çka ka shkaktuar pezullimin e procesit të votimit përkohësisht, duke krijuar rradhë në votim në rreth 22% të rasteve.

A funksionon në mënyrë të rregullt pajisja elektronike (PEI)?
100 responses



QV-3901, QV-3902, QV-39021, QV-3907, QV-39071, QV-3908

Bashkia Lezhë: QV-0734, QV-07341, QV-07481, QV-0736, QV-07361, QV-0738, QV-07381, QV-0740, QV-07401, QV-07402, QV-07403, QV-0709, QV-0712, QV-07121, QV-07091, QV-0735, QV-07351, QV-07321, QV-0732

Bashkia Malësi e Madhe: QV-0047, QV-00471, QV-00641, QV-00472, QV-0048, QV-00482, QV-00492, QV-00493, QV-00491

Bashkia Dibër: QV-1143, QV-11431, QV-1144, QV-11441, QV-1136, QV-11361, QV-1139, QV-11391, QV-1135, QV-11351, QV-1142, QV-11421, QV-1034, QV-10341, QV-1036, QV-10361, QV-1189, QV-1190, QV-1156, QV-1157, QV-1148, QV-1149, QV-1141, QV-11411

⁵⁴ QV 3908 (Bashkia Pogradec), QV 3907 (Bashkia Pogradec)


⁵⁵ QV 3269 të Bashkisë Berat votimi ka filluar rreth gjysëm ore me vonesë për shkak të mungesës së energjisë elektrike

Nënshkrimi nga ana e zgjedhësve dhe heqja e vizës në listën e votuesve të disponuar nga ana e anëtarëve të KQV-ve, si një detyrim i parashikuar në nenin 105 gërma c) të KZ, nuk është respektuar nga të gjitha KQV-të. Masivisht në QV 39201, QV 3291, QV 3292, QV 3279, QV 3280 dhe QV 3281/1 në Bashkinë Berat, të cilat përbëjnë rreth 10% të QV të monitoruara, anëtarët e KQV nuk kanë qenë të qartë mbi këtë detyrim ligjor.

KShH vlerëson se pavarësisht lehtësisë së grumbullimit dhe vlerësimit të të dhënave nëpërmjet përdorimit të sistemit teknologjik, KQZ duhet të kishte marrë masa për të udhëzuar QV në përballimin e situatës dhe në rast mosfunksionimi të pajisjes PEI. Pavarësisht se KQZ deklaroi se kishte një plan B, në momentin e ndërhyrjeve të padrejta në sistemin e krijuar nga ky institucion, nga vëzhgimet në terren u vërejt se QV-të nuk kishin parashikuar asnjë plan të tillë. Shkëputja e vazhdueshme e dritave në Bashkinë Pogradec ka bërë që procesi i votimit të pezullohet me procesverbal konstatues në mënyrë të vazhdueshme, derisa anëtarët e KQV-ve janë informuar rreth mundësisë së përpunimit të të dhënave nga PEI nëpërmjet funksionimit me bateri.


Kur zgjedhësi hyn në qendrën e votimeve a kontrollohet në të dyja duart?

100 responses



Në listën e zgjedhësve, a shënohet numëri i serisë të dokumentit?

100 responses



Pajisja PEI në mënyrë të përsëritur e ka bërë të pamundur leximin e gishtërinjve të moshuarve, duke krijuar disa pengesa apo vonesa për ta, por që janë zgjidhur nëpërmjet procedurave manuale apo procesverbaleve konstatuese.

Në rreth 38% të rasteve u konstatua se anëtarët e KQV-së nuk shënonin numrin e serisë së dokumentit të identifikimit të zgjedhësve në

listën e zgjedhësve, me pretendimin se një funksion i tillë realizohej nga pajisja PEI.

3.3.2 Akses i vëzhguesve të KShH-së gjatë votimit

Rreth 45 vëzhgues të KShH-së të lokalizuar në 5 Bashkitë e vendit monitoruan procesin e votimit në 100 QV.

Gjatë monitorimit të realizuar në 5 Bashki të vendit, vëzhguesit e KShH të akredituar nga KQZ kanë depozituar 21 vërejtje me shkrim drejt anëtarëve të KQV. Vëzhguesit e lokalizuar në Bashkinë Dibër kanë depozituar një numër më të lartë vërejtjesh me shkrim, kryesisht për rastet e konstatuara të votimit familjar.⁵⁶ Arsytet e depozitimit të vërejtjeve me shkrim nga ana e vëzhguesve të tjerë janë: prezenca e personave të paautorizuar⁵⁷; votimi i anëtarëve të KQV në


⁵⁶ QV 3889 (Bashkia Pogradec), QV 3898 (Bashkia Pogradec), QV 1143 (Bashkia Dibër), QV 1149 (Bashkia Dibër), QV 1189 (Bashkia Dibër), QV 1190 (Bashkia Dibër), QV 1157 (Bashkia Dibër), QV 1144 (Bashkia Dibër).

⁵⁷ QV 0493 (Bashkia Malësi e Madhe), QV 1034 (Bashkia Dibër), QV 1189 (Bashkia Dibër), QV 1190 (Bashkia Dibër), QV 1144 (Bashkia Dibër).

cënim të nenit 106/4 KZ;⁵⁸ nuk shënohet në listën e zgjedhësve emri i zgjedhësve dhe nuk nënshkruhet përbri emrit etj.⁵⁹

3.3.3 Procedura e paraqitjes së zgjedhësit pranë dhomës së fshehtë

Kur zgjedhësi hyn në qendrën e votimeve a kontrollohet në të dyja duart?
100 responses




Në 90% të rasteve u konstatua se zgjedhësi hyn në QV dhe kontrollohet në të dyja duart, por në 10% të rasteve një procedurë e tillë e detyrueshme nuk u realizua.


Zgjedhësi timbrosej në dorën e

majtë, ndërkohë boja ka rezultuar e një cilësie të mirë.

Zgjedhësi, a timbrosej në dorën e majtë nga anëtarë i KQV-së, i caktuar nga KQV-ja (boja për 24 orë nuk duhet të hiqet)? Nqs boja hiqet, ju lutem pasqyrojeni në seksionin koment.
100 responses



Nëse zgjedhësi paraqitet me vendim gjyqësorë a lejohet të votojë?
100 responses




Vetëm në 5% të

rasteve u konstatua paraqitja e zgjedhësve të cilët nuk ishin të regjistruar në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi por dispononin një vendim gjyqësor që ju njihte të drejtën për të votuar aty. Këto vendime u regjistruan në një protokoll të veçantë dhe kopje e

tyre u mbajt nga anëtarët e KQV-së.

Në zbatim të nenit 106 pika 4 të KZ, anëtarët dhe sekretari i KQV-së votojnë pasi kanë votuar të gjithë zgjedhësit e pranishëm në qendrën e votimit brenda orarit të mbylljes së votimit. **Por në 34% të rasteve ky parashikim ligjor nuk është respektuar.**

Sipas ligjit, anëtarët dhe sekretari i KQV-së votojnë pasi kanë votuar të gjithë zgjedhësit e parashikuar. A zbatohet ky rregull?
100 responses



Anëtarët dhe sekretari i këtyre KQV-ve kanë pretenduar se nuk kanë dijeni rreth këtij parashikimi ligjor, ndërkohë që disa të tjerë kanë vlerësuar momentet më me pak fluks të zgjedhësve për të ushtruar të drejtën e tyre të votës.

3.3.4 Prezenca e personave të paautorizuar në ambientet brenda dhe jashtë QV-ve

Me ndryshimet që pësoi neni 109 KZ, vërehet se prezenca e personave të paautorizuar tashmë nuk është një ndalesë cënuese e rendit dhe zhvillimit të rregullt të procesit të votimit edhe në ambientet jashtë QV-së (përveçse brenda). Me pretendimin se janë përgjegjës vetëm për rregullin brenda QV, anëtarët e komisionit në QV 3294 (Bashkia Berat) refuzojnë marrjen në dorëzim të vërejtjes së vëzhguesit për personat e paautorizuar në ambientet e jashtme. Gjatë monitorimeve të realizuara në 5 Bashkitë e vendit vërehet me shqetësim prezenca e personave të paautorizuar të cilët

⁵⁸ QV 3891 (Bashkia Pogradec)

⁵⁹ QV 3291 (Bashkia Berat) QV 3290/1 (Bashkia Berat)

udhëzojnë dhe ndihmojnë zgjedhësin për të identifikuar se në cilën QV rezulton i regjistruar. Gjithashtu, në ambientet brenda disa prej QV në Bashkitë Lezhë , Berat, Pogradec , Dibër dhe Malësi e Madhe , është konstatuar prezencë e personave të autorizuar nga KQZ si vëzhgues të subjekteve politike të cilët mbajnë shënim emrat e zgjedhësve në momentin kur lexohen nga ana e anëtarëve të QV. Përdorimi i bexhave në format të fotokopjuar dhe jo sipas modelit të miratuar nga ana e KQZ-së është vërejtur në rastin e vëzhguesve të subjekteve politike, bexhat e të cilëve janë nënshkruar nga kryetari i KZAZ.

Edhe pse është konstatuar në masivitet prezencja e personave të paaautorizuar në zonën e oborreve të QV (brenda perimetrit), anëtarët e KQV-ve të monitoruara, në asnjë rast nuk kanë kërkuar ndërhyrjen e përfaqësuesve të Policisë së Shtetit.

3.3.5 Zgjedhësit që nuk votojnë vetë


Në rreth 76% të rasteve është konstatuar se anëtarët e KQV-së kanë respektuar parashikimin ligjor të parashikuar në nenin 108 KZ. **Në 2% të rasteve nuk u mbajt procesverbal nga ana e KQV, pavarësisht se zgjedhësit kishin probleme me shikimin dhe u ndihmuan nga familjarët e tyre, të cilët rezultonin zgjedhës në të njëjtën QV. Diferenca e rasteve të tjera konsiston në QV dytësore dhe lëvizëse, në të cilat nuk është monitoruar ky element.** Gjithashtu, një tjetër element i konstatuar janë deklaratat e vëna nga ana e KQZ-së në të cilat nënshkruante personi që ndihmohej dhe familjari që asistonte. **Këto deklarata në disa QV ishin të pakëta në numër, ndërkohë që anëtarët e KQV u detyruan t'i shumëfishonin në kancelari me të ardhurat e tyre, në mënyrë që procesi të mos pengohet.**

3.3.6 Votimi familjar dhe fotografimi i votës

Elementi i votimit familjar është ngatërruar në mënyrë të vazhdueshme nga disa anëtarë të QV me asistencën që ju ofrohet zgjedhësve të cilët nuk votojnë vetë, sipas nenit 108 KZ. Gjatë

A u lejuar në ndonjë rast votimi familjar? Ka përgjegjësi KQV-ja nëse do të lejojë votim familjar (Për këtë duhet të njoftohet menjëherë KShH-ja dhe mun...ë mos lejojë pasi është shkelje e Kodit Zgjedhor)


100 responses



vëzhgimit të procesit të votimit në 5 Bashki të vendit është referuar në 4% të rasteve nga ana e vëzhguesve prezencë e familjarëve në QV, të cilët votojnë bashkarisht. Prej anëtarëve të QV 1157 dhe 1144 (Bashkia Dibër) nuk është pranuar marrja në dorëzim e vërejtjes së vëzhguesve të KShH-së për këto shkelje dhe rrjedhimisht nuk janë protokolluar. Neni 4 gërma “c” e KZ ka parashikuar

kompetencën për administratën zgjedhore për marrjen e masave për shmangien e votimit familjar, ky fenomen shqetësues është konstatuar në QV 3889 dhe 3908 (Bashkia Pogradec) dhe QV 1143, 1149, 1144, 1157 të Bashkisë Dibër. Në të gjitha rastet vëzhguesit e KShH kanë depozituar vërejtje me shkrim, por jo në të gjitha rastet ka qenë i mundur parandalimi i kësaj shkelje.

A ka raste të fotografimit të votes nga ana e zgjedhësit?
100 responses



Shkelja e fshehtësisë së votës nëpërmjet fotografimit të saj ngarkon me përgjegjësi penale individuale në bazë të nenit 327 K.Penal çdo shtetas që ndërmerr një akt të tillë. Raste të hyrjes në dhomën e fshehtë me celular dhe konstatimit të përdorimit të tij janë raportuar nga ana e vëzhguesve të KShH në 2%, përkatësisht në QV 3889 dhe 3891/2 (Bashkia Pogradec), si dhe QV 1157

(Bashkia Dibër). Pavarësisht se anëtarët e KQV gëzojnë tagrin e vënies në dijeni të punonjësve të Policisë së Shtetit, kjo e drejtë në asnjë rast nuk është ushtruar prej tyre. Shtetasit ose janë këshilluar verbalisht, ose i është vlerësuar e pavlefshme fleta e votimit dhe i është dhënë një tjetër fletë votimi.

3.4 Votimi në QV të posaçme pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)

Sipas të dhënave zyrtare të përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile rezultojnë se për shkak të vendimmarrjeve të formës së prerë, iu është pezulluar e drejta e votës rreth 170 shtetasve banorë të 5 Bashkive objekt monitorimi, të cilët rezultojnë nën statusin procedural të dënuar.⁶⁰

Vëzhguesit e akredituar të KShH monitoruan procesin e votimit të shtetasve të paraburgosur, të akomoduar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Shënkoll dhe Reç. Në burgjet e vendit tonë, në përputhje me nenin 2 të KZ ngrihen dhe funksionojnë Qendra Votimi (QV) të posaçme. Në QV të posaçme nr. 07481 të vendosur në IEVP Shënkoll (Lezhë) rezultojnë të regjistruar 138 votues. Ndërkohë në QV nr. 00641, në IEVP Reç (Shkodër) konstatohen 373 shtetas me të drejtë vote. Deri në përfundim të mbylljes së votimit në QV Lezhë është raportuar se kanë votuar 87 shtetas (rreth 63%), ndërkohë në QV të ngritur pranë IEVP Reç deri në orën 13:20 të datës 25.04.2021 rezultojnë të kenë votuar 56 të paraburgosur (rreth 15%).

Në QV në IEVP Shënkoll është referuar se vendimmarrja për hapjen e votimit mban orën 07:00, por sistemi PEI në këtë QV nuk është vënë në funksion për shkak të mungesës së operatorit. Për arsye të sigurisë dhe domosdoshmërisë së kontrolleve, afishimi i materialeve edukative për zgjedhësit dhe i masave anti-Covid19 është realizuar disa minuta përpara hapjes, nga ana e anëtarëve të QV.

Situata në QV pranë IEVP Reç paraqitet paksa e ndryshme, pasi votimi është hapur në orën 08:43, për shkak se në kutinë e materialeve mungonte procesverbali i hapjes së votimit. Në QV është konstatuar gjendje e qetë, pa incidente dhe pa prezencë të përfaqësuesve të Policisë së Burgjeve në ambientet e brendshme të QV.

Vëzhguesit e KShH-së në këto QV nuk kanë raportuar rast intimidimi apo ushtrim presioni nga ana e punonjësve të Policisë së Burgjeve apo përfaqësuesve të administratës së institucionit, me qëllim ndikimin mbi vullnetin e shtetasve të privuar nga liria. Për të dyja QV të vendosura në


⁶⁰ Shkresë nr. 1696/1 prot, dt. 14.05.2021.

28 shtetas në Bashkinë Berat; 7 shtetas në Bashkinë Dibër; 25 shtetas në Bashkinë Lezhë; 97 shtetas në Bashkinë Malësi e Madhe dhe 13 shtetas në Bashkinë Pogradec.

IEVP-të është vërejtur se 20 të paraburgosur janë paraqitur me vendim gjyqësor dhe janë identifikuar si raste të veçanta nga PEI. Transporti i kutive të votimit dhe materialeve të votimit në QV 07481 (IEVP Shënkoll) u realizua me makinën e kryetarit të QV-së, në prezencën e sekretarit dhe 1 oficeri të Policisë së Shtetit, në përputhje me nenin 114 KZ.

3.5. Mbyllja e votimit

A u mbyll votimi në orën 19:00?
100 responses




Në 72% të rasteve rezulton se votimi u mbyll në orën 19.00, ndërkohë që në 10% të rasteve nga ana e anëtarëve të KQV nuk u respektua dot ky orar ligjor, pasi u konstatua një vonesë 10 min. Në 4 raste, pas orarit zyrtar të mbylljes u konstatua se zgjedhësit qëndronin në radhë për të votuar, si rrjedhojë anëtarët e KQV respektuan procedurën e

parashikuar në nenin 112 pika 1 KZ.

Për shkak të funksionimit të pajisjes PEI, anëtarët e KQV-ve janë mjaftuar me printimin e procesverbalit automatik që gjeneronte kjo pajisje, ndërkohë në një procesverbal të veçantë i cili nënshkruhet nga ana e të gjithë anëtarëve të KQV-së, pasqyrohen fletët e votimit të dëmtuara dhe të papërdorura.

Pas kësaj fillon numërimi i zgjedhësve që kanë votuar sipas nënshkrimeve në listë plus atyre që kanë votuar me vendim gjyqësor. Për këtë a mbahet proces-verbali përkatës?
100 responses




Në 4% të rasteve, njëri nga anëtarët e KQV-së kërkoi rinumërimin e fletëve të votimit, për shkak të mos rakordimit. Nga ana e kryetarit u pranua kjo kërkesë dhe fletët e votimit u rinumëruan më shumë se 2 herë. Gjithashtu, në 14% të rasteve u konstatua se vëzhguesve të subjekteve zgjedhore nuk iu jepej kopje e procesverbaleve të mbylljes së votimit.

Përcjellja e materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit nga ana e KQV-ve pranë VNV-ve u realizua në 76% të QV të monitoruara brenda afatit të përcaktuar 3 orë, me prezencën e anëtarëve të KQV-së, sekretarit dhe punonjësit të policisë. Vetëm në 1 rast nuk u respektua një detyrim i tillë ligjor, për shkak të mosprezencës së përfaqësuesit të Policisë së Shtetit për të shoqëruar të dyja makinat me materiale zgjedhore. Ky rast u regjistrua në QV nr. 0740, të KZAZ nr. 12 pranë Bashkisë Lezhë.

4 Numërimi i votave

KShH ka monitoruar procesin e numërimit të votave në ambjentet e 9 Vendeve të Numërimit të Votave (VNV), të vendosura pranë 9 ZAZ në 5 bashkitë e mësipërme. Ky monitorim ka zgjatur deri në orët e pasdites të datës 26 Prill 2021. Vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar se lodhja e anëtarëve të GNV-ve, ka shkaktuar në mënyrë të vazhdueshme ndërprerje të këtij procesi.


A keni pasur akses të plotë për të hyrë në vendin e numërimit?
18 responses



Akresi i vëzhguesve në fazën e monitorimit të procesit të numërimit të votave është garantuar në 94.4 % të rasteve, ndërkohë në 5.6% të rasteve janë konstatuar kufizime të këtij akresi.

4.1 Respektimi i procedurave ligjore gjatë numërimit


Kutia e votimit dhe kutia e materialeve të votimit duhet të dorëzohet në vendin e numërimit të votave jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit. ... grupet e marrjes në dorëzim caktohen nga KZAZ-të?
18 responses



Në 44.4% të rasteve, afati për marrjen në dorëzim të kutive të votimit dhe kutive të materialeve të votimit është respektuar, ndërkohë që në 5 raste ose 27.8% e numrit total të rasteve ka qenë i pamundur respektimi i këtij afati ligjor për shkak të largësisë së QV nga VNV e përcaktuara, vonesës në mbylljen e procesverbaleve, paqartësisë së anëtarëve të KQV-ve mbi procedurat që duhet të ndiqnin

etj.

A mbahet procesverbal pas marrjes në dorëzim të Kutive me Fletët e Votimit dhe materialet e votimit?
18 responses




Në 55.6% të rasteve, ka rezultuar se anëtarët e GNV-ve kanë mbajtur procesverbal në momentin e marrjes në dorëzim të materialeve dhe kutive të votimit, ndërkohë që 44.4 % të rasteve, vëzhguesit nuk kanë monitoruar dot këtë moment procedural, për shkak se janë angazhuar në monitorimin e fazës së dytë të procesit të numërimit i cili ka vijuar në orët e paradites së dt. 26 Prill 2021.

Në 94.4% të rasteve (ose 17 raste), vëzhguesit e KSHH-së nuk kanë konstatuar hapje të kutive të


parregullta nga KZAZ, në respektim të nenit 115 pika 5 KZ. Në 1 rast, që reflekton 5.6% të rasteve, 1 kuti që i përket QV 3890 është dorëzuar në VNV pranë ZAZ nr. 69 (Bashkia Pogradec) e dëmtuar, ka rezultuar e këputur vula e sigurisë, ndërkohë që është mbyllur përkohësisht. Për këtë shkak është njoftuar KZAZ, anëtarët e

Kutitë e parregullta, ligji nuk lejon të hapen. A zbatohet ky rregull?
18 responses



së cilës kanë verifikuar rastin dhe kanë mbajtur procesverbal për këtë konstatim. Pas mbajtjes së procesverbalit, në cënim të dispozitës së sipërcituar kjo kuti votimi i është nënshtruar procesit të numërimit.


A merr vendim të posaçëm KZAZ-ja për fillimin e numërimit të votave?
18 responses



Në 11 raste ose në 61.1% të numrit total të rasteve, KZAZ ka marrë vendim për fillimin e numërimit të votave, ndërkohë KZAZ nr. 13 në Bashkinë Lezhë (e cila përbën 5.6% të rasteve) nuk ka marrë vendim në mënyrë të shprehur për fillimin e procesit të numërimit, por është shprehur rreth procedurës që do të ndiqet në numërimin, në dy fazat përkatëse, fillimisht për subjektet

zgjedhore dhe më pas për kandidatin parapëlqyes. Ndërkohë shifra prej 33.3% e rasteve në të cilat vëzhguesit nuk kanë ofruar informacion, i përket 6 rasteve në të cilat vëzhguesit janë angazhuar në turnin e dytë.

A ka pasur kontestime dhe vërejtje për procesin e fillimit të numërimit të votave?
18 responses




Kontestime dhe vërejtje për procesin e fillimit të numërimit të votave janë raportuar nga ana e vëzhguesve në 3 raste, të cilat përbëjnë 16.7%, më konkretisht: ZAZ nr. 69 dhe nr. 70 në Bashkinë Pogradec, dhe ZAZ nr. 65 pranë Bashkisë Berat. Kontestimet janë adresuar nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, të cilët kanë patur prezencë të shtuar të personave të paautorizuar në


VNV. Shkaqet e kundërshtimeve lidhen me kalimin e shpejtë të fletëve të votimit në monitor ose për shkak të vonesës së paargumentuar nga GNV-të të fillimit të procesit të numërimit të votave.

Në rastet kur anëtarët e GNV-ve pretendojnë se janë hasur me parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave, neni 116 pika 7 KZ, njeh të drejtën e pezullimit të procesit të numërimit, nëpërmjet ngritjes së dorës. Në 50% ose në 9 prej rasteve në VNV-të e monitoruara, numërimi është pezulluar në momentin që një nga anëtarët e GNV-ve ka ngritur dorën, ndërkohë që KZAZ është paraqitur për zgjidhjen e situatës. Këto raste janë raportuar në ZAZ nr. 12 dhe ZAZ nr. 13 (Bashkia Lezhë); ZAZ nr. 1 (Bashkia Malësi e Madhe); ZAZ nr. 19 (Bashkia Dibër); ZAZ nr. 69 (Bashkia Pogradec) dhe ZAZ nr. 65 dhe 66 (Bashkia Berat).

Në rastet kur një prej anëtarëve të GNV ka ngritur dorën dhe ka sinjalizuar KZAZ për çrregullimet e lartpërmendura apo ato të përmendura më poshtë....arët e GNV deri në marrjen e vendimit nga KZAZ?
18 responses




Fletët e votimit, sipas ligjit, të stivuara, vendosen mbi tryezë, numërohen nga numëruesi i parë dhe u bëhet të ditura anëtarëve të grupit të numërimit ...gjedhore. A është respektuar ky parashikim ligjor?
18 responses



Në të gjitha VNV-të e monitoruara nga vëzhguesit e KShH është konstatuar se fletët e votimit janë vendosur mbi tryezë, dhe pas numërimit nga numëruesi i parë i janë bërë të ditura anëtarëve të GNV-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Në ato VNV ku është shtrirë monitorimi, vëzhguesit kanë konstatuar se në 100% të rasteve numri i fletëve të votimit është përputhur me

numrin e zgjedhësve në listat respektive.


A përputhet numri i fletëve të votimit me listën e zgjedhësve që kanë votuar?
18 responses



Vetëm në rastin e ZAZ nr. 66 në Bashkinë Berat, gjatë shqyrtimit të një QV ka rezultuar se në kutinë e materialeve të votimit nuk është gjendur procesverbali i mbylljes së procesit të votimit. Në këtë rast GNV ka plotësuar procesverbalin e konstatimit, referuar nenit 116/1 KZ.


Fleta e votimit është ekspozuar në mënyrë të dukshme në monitor në të gjitha VNV-të objekt monitorimi. Në 1 rast vëzhguesi i KShH i vendosur pranë ZAZ nr. 66 (Bashkia Berat) ka raportuar se fleta e votimit ishte e paqartë që të shikohej në monitor për shkak të cilësisë së dobët të monitorit.

Në vlerësimin e votave, a bëhet dallimi midis votës së vlefshme dhe të pavlefshme? SHPJEGIM
(Vota e vlefshme është ajo në të cilën është votuar...erson ose subjekt që nuk është në fletën e votimit.
18 responses



Vlerësimi i votave në ato të vlefshme dhe të pavlefshme është realizuar nga ana e anëtarëve të GNV-ve në 9 ZAZ jo në mënyrë të unifikuar, duke lexuar me zë të lartë vlerësimin përkatës, por duke mos argumentuar gjithmonë, shkakun e pavlefshmërisë.

A ka pasur kontestime gjatë numërimit të votave?
18 responses



Gjatë monitorimit një ditë të procesit të numërimit në VNV-të e këtyre Bashkive, ka rezultuar një përqindje votash të pavlefshme që varion nga 6% - 9%. Konkretisht: në Bashkinë Bulqizë u konstatuan rreth 8.8% e votave të pavlefshme, nga 15409 votues, 1362 vota të pavlefshme, në Bashkinë Dibër rreth 6% e votave u vlerësuan të pavlefshme, 30014 vota në total, nga të cilat 1814 të pavlefshme, në Bashkinë Malësi e Madhe nga 17392 vota në total rezultoi se 1346 vota janë të pavlefshme ose rreth

7.7%, në Bashkinë Pogradec rreth 8% e votave janë shpallur të pavlefshme 34734 vota në total, nga të cilët 2810 të pavlefshme, në Bashkinë Berat, nga 34772 vota në total, 2179 rezultuan të

pavlefshme ose rreth 6.3% dhe, në Bashkinë Lezhë, nga 37770 vota në total, 2509 u vlerësuan të pavlefshme ose rreth 6.6%).

Në 10 raste gjatë procesit të numërimit të votave, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore kanë përcjellë tek anëtarët e GNV-ve kundërshtime ose ankesa. Vetëm në 5 raste, kundërshtimet janë shënuar në librin e protokollit të administruar nga anëtarët e KZAZ të pranishëm në VNV. Këto kontestime kanë pasur si objekt: kalimin e shpejtë të fletëve të votimit në monitor; pamundësinë e shqyrtimit të vulave të vendosura në pjesën e pasme të fletës së votimit, pretendime për vlefshmërinë ose jo të fletës, etj.⁶¹ Pavarësisht këtyre kontestimeve, situata ka vijuar normalisht në pjesën më të madhe të VNV-ve, pa shkaktuar rinumërim të votave, me përjashtim të GNV nr. 3 dhe nr. 5 në ZAZ 12 në Bashkinë Lezhë, tek të cilat KZAZ vendosi që votat të rinumëroheshin për një kuti.

Vetëm në 10 raste ose 55.6% e numrit total të VNV të monitoruara, vëzhguesit kanë mundur të monitorojnë procesin e hartimit të tabelave origjinale me rezultatet e votimit, të cilat u janë vënë në dispozicion vëzhguesve të subjekteve politike. Gjatë hartimit të tabelës së rezultateve, vëzhguesit nuk kanë raportuar kundërshtime, ndërkohë që tabela është nënshkruar nga ana e të gjithë anëtarëve të GNV.

Në përfundim të procesit të numërimit të votave, KAS ka publikuar vendimmarrjen e parë lidhur me kërkesat ankimore të depozituara mbi veprimtarinë në cënim të parashikimeve ligjore nga ana e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ nr. 66 pranë Bashkisë Berat. Në vendimmarrjen e tij, KAS relaton se në orën 22:00 të dt. 26 Prill 2021, vetëm 42.22% e numrit total të kutive të votimit rezultonin se ishin numëruar nga ana e anëtarëve të GNV funksionale pranë kësaj KZAZ. Duke konstatuar cënim të nenit 122, pika 1 KZ, Komisioneri vendosi sanksion administrativ ndaj anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ. Kjo vendimmarrje është shfuqizuar nga ana e KAS, i cili ka argumentuar se përgjegjësia për procesin e numërimit i përket GNV-ve, ndërkohë që procedura e dyfishtë e numërimit të votave për subjektin zgjedhor dhe kandidatin parapëlqyes e bën të pamundur respektimin e orarit 22:00 të ditës pasardhëse të votimit.⁶²

⁶¹ P.sh: në VNV pranë ZAZ nr. 66 (Bashkia Berat), vëzhguesi ka raportuar se pretendimi se fleta e votimit kalohej shumë shpejtë në monitor është ngritur në mënyrë të vazhdueshme nga kandidatët e subjekteve politike. Pas ndërhyrjes së KZAZ-së, me konsensus u këshilluan anëtarët e GNV që të paraqisnin në një minutazh më të gjatë kohor fletën e votimit në monitor.

⁶³ http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim_349_210504_V349_TPR-Qarku-Lezhe.pdf

4.2 Klima në VNV dhe prania e personave të paaautorizuar

Vëzhguesit e KShH-së që vëzhguan procesin e numërimit të votave në 9 ZAZ-të e 5 Bashkive objekt monitorimi, kanë raportuar në mënyrë të përsëritur se anëtarët e GNV e kanë ushtruar funksionin në kushte tepër të vështira. Gjatë numërimit, vëzhguesit e kanë kryer detyrën në një ambient të zhurmshëm, me prani të shumë personave jo të pajisur me bexha akreditimi, si dhe në cënime të masave anti Covid-19. Prezencë e shtuar e tymit të duhanit dhe zhurma të



konsiderueshme u konstatuan në ZAZ 1 në Bashkinë Malësi e Madhe dhe ZAZ 69 në Bashkinë Pogradec, gjatë orëve të para të mëngjesit të dt. 26 Prill 2021.

Gjithashtu, prezenca e personave të paaautorizuar, të cilët kanë bashkëbiseduar në mënyrë të vazhdueshme me anëtarët e GNV-ve, është raportuar në VNV pranë ZAZ nr. 70 (Bashkia Pogradec), në momentin që janë referuar kontestime nga ana e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, kur vota vlerësohej si e pavlefshme. Ndërkohë situata tensioni janë konstatuar në pjesën më të madhe të rasteve, gjatë orëve të para të mëngjesit të dt. 26 Prill 2021, për shkak të lodhjes dhe pezullimit të procesit të numërimit nga ana e anëtarëve të GNV.



4.3 Miratimi i tabelave përmbledhëse

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 123 KZ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezulton të ketë marrë vendim për të 5 Bashkitë objekt monitorimi, lidhur me miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonat zgjedhore respektive.⁶³

Referuar nenit 167 KZ, rezultati përfundimtar i Zgjedhjeve për Parlamentin e Shqipërisë të mbajtura më dt. 25 Prill 2021, është i kushtëzuar së pari, nga llogaritja dhe shpërndarja e mandateve për kandidatët fitues, dhe së dyti, nga përfundimi i procedurave të ankimit. Si rrjedhojë, afati 5 ditor i përcaktuar në këtë dispozitë është i kushtëzuar nga dy kushtet e sipërcituara. Aktualisht nuk rezulton që KQZ të ketë shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, ndërkohë që procedura e ankimit vijon pranë KAS ose Kolegjit Zgjedhor.

⁶³ http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim_349_210504_V349_TPR-Qarku-Lezhe.pdf
http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim_346_210504_V346_TPR-Qarku-Korce.pdf
http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim_341_210501_PV_TPR-Qarku-Diber.pdf
http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendim_339_210501_V_339-TPR-Qarku-Berat.pdf

4.4 Procedura e ankimit pranë KAS

KShH konstaton se periudha paszgjedhore e ka përballur KAS me një sërë ankimesh të depozituara nga ana e subjekteve zgjedhore. Më konkretisht rreth 40 vendimmarrje rezultojnë të jenë marrë nga KAS, nga data 29 Prill 2021 deri në ditën e hartimit të këtij raporti.

KAS ka vijuar në mënyrë proaktive shqyrtimin e ankimeve të depozituara nga subjektet zgjedhore. Nga monitorimi i realizuar nga media, rezultojnë se mbledhjet e KAS janë shoqëruar me debate ndërmjet anëtarëve dhe përfaqësuesve ligjorë të subjekteve zgjedhore, ndërkohë që gjatë debateve janë vërejtur ndasi politike në qëndrimet e anëtarëve të KAS.

Më dt. 17 Maj 2021, KAS vendosi hapjen e 24 kutive të materialeve zgjedhore në Berat, nga të cilat rezultojnë se janë evidentuar problematika dhe mangësi të procesverbaleve, mungesë të raporteve të gjeneruara nga pajisja PEI, mospërputhje e numrit të votuesve me numrin e fletëve të votimit në një QV dhe mungesë e listës së zgjedhësve.

REKOMANDIME:

1. Duke qenë se këto Zgjedhje Parlamentare u realizuan në kushtet e pandemisë, KShH i bën thirrje Policisë së Shtetit që në të ardhmen t'i ushtrojë vëmendjen e duhur domosdoshmërisë së garantimit të parimit të barazisë së ligjit për çdo qytetar, pavarësisht bindjes dhe përkatësisë politike, si dhe shmangies së praktikave diskriminuese favorizuese ndaj lirisë së tubimit paqësor.
2. Referuar të dhënave paraprake të publikuara nga KQZ, KShH sugjeron analizë më të thelluar në të ardhmen të shkaqeve që nxisin një numër të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme, me qëllim që ato të adresohen efektivisht në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.
3. KShH i rekomandon KQZ-së marrjen e masave që në zgjedhjet e ardhshme të zbatojë me rigorozitet parashikimin ligjor në nenin 174 të Kodit Zgjedhor.
4. KShH i rekomandon KQZ-së që të ndërmarrë hapa proaktivë në realizimin e hetimit administrativ të shpejtë, efikas dhe objektiv të rasteve apo sinjalizimeve të lidhura me shpërdorimin e aseteve publike, duke treguar rigorozitet në zbatimin e ligjit dhe sanksionimin e shkelësve konform nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe Vendimit nr. nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
5. Lidhur me incidentet e bëra mediatike, gjatë fushatës zgjedhore, KShH i bën thirrje Prokurorive të Rretheve Gjyqësore dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) për të ndërmarrë hetime të gjithanshme, objektive dhe të shpejta, me qëllim ndëshkimin e shtetasve përgjegjës që kanë synuar cënimin e votës së lirë dhe të ndershme të qytetarëve në Zgjedhjet Parlamentare Prill 2021.

6. KShH sugjeron marrjen e masave nga ana e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore për informimin e publikut, në mungesë të faqeve të tyre elektronike individuale, nëpërmjet njoftimeve statistikore në faqen zyrtare të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë. KShH tërheq vëmendjen se e drejta e informimit për hetimin e krimeve zgjedhore është në funksion të interesit publik, ndaj në këtë drejtim inkurajohen analizat e realizuara mbi bazë rrethesh gjyqësore dhe ndarjen me publikun të vështirësitë apo pengesat e ndeshura në hetimin e këtyre veprave penale. KShH vlerëson thirrjet publike dhe takimet periodike të realizuara nga Prokurori i Përgjithshëm me përfaqësuesit e organit të akuzës në nivel vendor.
7. Me synim parandalimin e fenomenit të shitëblerjes së votës, KShH sugjeron intensifikimin e punës nga ana e KQZ-së për edukimin e zgjedhësve, për pasojat e dënueshme që sjell shitëblerja e votës.
8. KShH i rekomandon KQZ-së marrjen e masave konkrete për menaxhimin konform parashikimeve ligjore në fuqi të trajnimit me cilësi të administratës zgjedhore në nivel vendor, me synim shmangien e sesioneve trajnuese brenda afateve të ngushta kohore, të cilat rezultojnë me mungesë të efikasitetit të procesit të administrimit të votimit dhe të numërimit të votave.